




Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action

# RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE


Zgjedhjet e Parakohshme  
për Kuvendin e Kosovës

14 shkurt, 2021



Mars, 2021





**Raporti  
Përfundimtar  
i Vëzhgimit të  
Zgjedhjeve:  
Zgjedhjet e  
Parakohshme  
për Kuvendin e  
Kosovës**

**Raporti i Monitorimit  
të Fushatës Zgjedhore:  
Zgjedhjet e Parakohshme  
për Kuvendin e Kosovës**

**Raporti i Monitorimit të  
Mediave Gjatë Fushatës  
Zgjedhore: Zgjedhjet e  
Parakohshme  
për Kuvendin e Kosovës**

---

Copyright ©2021 . Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ambasadës Gjermane në Kosovë, Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Ambasadës së Zvicrës në Kosovë.

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

**Demokracia në Veprim**

Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 239

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 248 038

[www.demokracianeveprim.org](http://www.demokracianeveprim.org)

# Përmbajtja

<b>Lista e akronimeve</b>	6
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	7
<b>1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË</b>	10
<b>2. KONTEKSTI POLITIK</b>	12
<b>3. KORNIZA LIGJORE</b>	14
<b>4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE</b>	16
4.1 Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	16
4.2 Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve	18
4.3 Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve	19
4.4 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre	20
4.5 Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve	23
4.6 Votimi jashtë vendit	24
<b>5. FUSHATA ZGJEDHORE</b>	27
5.1 Shpenzimet e Subjekteve Politike	28
<b>6. PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCES ZGJEDHOR</b>	30
<b>7. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE</b>	34
<b>8. DITA E ZGJEDHJEVE</b>	35
<b>9. REZULTATET ZGJEDHORE</b>	37
<b>10. DREJTËSIA ZGJEDHORE</b>	39
<b>REKOMANDIMET</b>	43
I. Reforma e sistemit zgjedhor	43
II. Administrimi i procesit zgjedhor dhe trupat menaxhuese të zgjedhjeve	43
III. Menaxhimi i zgjedhjeve në pandemi	45
IV. Votimi jashtë vendit	45
V. Dizajni i fletëvotimit	45
VI. Informimi i votuesve	45
VII. Fushata zgjedhore	46
VIII. Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës	46
IX. Lista e votuesve	46
X. Përfaqësimi gjinor	47
XI. Drejtësia zgjedhore	47
<b>Shtojca 1: Rezultatet e certifikuar të zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike</b>	48

---

## Lista e akronimeve

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
BE	Bashkimi Evropian
COVID-19	Sëmundja e shkaktuar nga koronavirusi SARS-nCoV2
DnV	Demokracia në Veprim
EU-EOM	Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian
FRK	Formulari i Rezultateve të Kandidatëve
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKZ	Komisionet Komunale Zgjedhore
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LTO	Vëzhgues Afatgjatë
LS	Lista Serbe
LPV	Lista Përfundimtare e Votuesve
LVV	Lëvizja Vetëvendosje!
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
NDS	Partia e Re Demokratike
NISMA	Nisma Socialdemokrate
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PVT	Numërimi Paralel i Votave
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
SDU	Unioni Socialdemokrat
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
STO	Vëzhgues Afatshkurtër
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZRPPC	Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

---

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit u shpallën pas aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte konstatuar se Qeveria 'Hoti' nuk ishte zgjedhur në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Koalicioni i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" vlerëson që zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit janë zhvilluar në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira dhe të drejta. Përjashtim në këtë kualifikim përbën votimi në **komunat me shumicë serbe**, ku është evidentuar **votim i orkestruar** për dy subjekte politike nga radhët e komuniteteve, si dhe **dalje e pazakontë** e votuesve në zgjedhje deri në 85%.

Qytetarët e Kosovës dëshmuar një kulturë të lartë demokratike duke dalë në masë të konsiderueshme për të votuar, përkundër motit të keq dhe situatës me pandeminë. **Dalja e përgjithshme e votuesve** në këto zgjedhje ishte 48.78%, që përbën përqindjen më të lartë të daljes në zgjedhjet parlamentare të organizuara pas shpalljes së pavarësisë. Gjithashtu edhe subjektet politike, përmes **pranimit të menjëhershëm të rezultatit** të zgjedhjeve dhe shpallja ekspeditive e rezultateve preliminare nga KQZ, i kanë dhënë një vlerë të shtuar procesit zgjedhor.

**Dita e zgjedhjeve** është zhvilluar e qetë dhe pa ndonjë incident serioz që do të mund të ndikonte në integritetin e procesit zgjedhor. Procesi i votimit ishte i rregullt, mirëpo i njëjti është karakterizuar nga disa **probleme të përsëritura** nga ciklet e mëparshme zgjedhore, si shkalla e lartë e votimit me asistencë, rastet e shtuara të votimit me asistencë të parregullt dhe vështirësitë e votuesve për të gjetur vendvotimet të tyre. Gjatë ditës së zgjedhjeve, nga vëzhguesit e DnV-së është raportuar për nivel jo të kënaqshëm të **respektimit të masave anti-COVID**, si nga stafi zgjedhor ashtu edhe nga qytetarët.

**Procesi i numërimit të votave**, sidomos të kandidatëve të subjekteve politike, vlerësohet si një prej problematikave kryesore të procesit zgjedhor. Implikimi i personave të dyshuar në vepra penale të falsifikimit dhe manipulimit të rezultateve zgjedhore në QNR, e dëshmuar përmes publikimit të një video-incizimi, ka zbehur kredibilitetin e këtij procesi.

**Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve** ka qenë përgjithësisht e rregullt, e hapur dhe transparente për publikun. QNR ka publikuar vazhdimisht të gjitha kopjet e skanuara të formularëve të rezultateve për subjektet politike dhe kandidatët për secilin vendvotim. QNR ka rritur në disa raste kapacitetet e tavolinave të numërimit, duke arritur të përmbyllë në afate optimale proceset e numërimit dhe rinumërimit.

Ndonëse numri i **vendvotimeve të rinumëruara** është dukshëm më i ulët se në zgjedhjet e vitit 2019, sërish, rinumërimi i rreth 700 kutive apo 29% të numrit të përgjithshëm të vendvotimeve, e përcjellë edhe me përsëritjen e numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë për një subjekt politik, shpërfaqë politizimin e thellë dhe mungesën e integritetit në mesin e disa komisionerëve dhe stafit të QNR-së.

Korniza ligjore që rregullon organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor nuk ka ndryshuar substancialisht në këto zgjedhje. Megjithatë, KQZ në disa raste ka ndërhyrë në legjislacionin sekondar zgjedhor, duke **ndryshuar rregullat e lojës** gjatë procesit. Reforma zgjedhore, ndonëse e filluar në vitin 2011, ka mbetur e papërfunduar si rezultat i mungesës së vullnetit politik si dhe një atmosfere të polarizuar politike.

---

**Puna e KQZ-së** ka qenë kryesisht transparente, duke njoftuar në pothuajse të gjitha rastet e mbajtjes së mbledhjeve. Sidoqoftë, shpesh materialet nuk janë publikuar në kohë në faqen elektronike të KQZ-së, si dhe të njëjtat nuk janë ndarë paraprakisht me palët e interesuara.

Atipike për këtë proces zgjedhor ishin **polarizimi dhe përplasjet e verbale** të vazhdueshme mes anëtarëve të KQZ-së. Kjo ka ndikuar që shumica e mbledhjeve të ndërpriten apo të shtyhen. Po ashtu, puna dhe pavarësia e KQZ-së janë cenuar edhe nga **ndërhyrjet nga palët e jashtme**, posaçërisht nga Ushtruesja e Detyrës së Presidentit përmes deklaramëve të saj publike ndaj Kryetares së KQZ-së. Kryetarja ka qenë target i sulmeve të shumta edhe nga Lëvizja Vetëvendosje, por edhe palë tjera.

KQZ-ja, përkundër **afateve të shkurtuara**, ka arritur t'i përmbyllë pothuajse të gjitha aktivitetet dhe operacionet zgjedhore pa vonesa. Përgjatë bën vetëm votimi jashtë vendit, një pjesë e së cilit, për shkak të vendimit të KQZ-së për verifikimin e aplikacioneve, nuk ishte përmbyllur brenda afatit.

**Operacioni i votimit jashtë vendit** vlerësohet sërish si një prej hallkave më të ndjeshme të procesit zgjedhor. Në këto zgjedhje është shënuar interesim i jashtëzakonshëm i votuesve jashtë vendit për të marrë pjesë në zgjedhje. Me rreth 200 mijë aplikacione të pranuar, prej të cilave mbi 100 mijë ishin konfirmuar, KQZ-ja është dashur të rrisë dinamikën e punës dhe të mobilizojë resurse të mëdha njerëzore e financiare për t'a administruar këtë operacion.

**Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre** është shoqëruar me probleme dhe përplasje të shumta, si rezultat i interpretimit të ndryshëm të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me përshtatshmërinë juridike të kandidatëve. Për të garuar në zgjedhje, fillimisht kanë aplikuar 28 subjekte politike me 1,081 kandidatë, por pas vendimeve të PZAP-së dhe Gjykatës Supreme lidhur me papërshtatshmërinë e kandidatëve, numri përfundimtar i kandidatëve kishte rënë në 1,052 sosh.

Pothuajse të gjitha subjektet politike kanë respektuar vetëm kriterin minimal të **përfshirjes së grave në lista**. Vetëm 359, apo 34%, nga gjithsej 1,052 kandidatët e certifikuar ishin gra. KQZ-ja, edhe në këto zgjedhje ka

vijuar me praktikën e renditjes së subjekteve politike në fletëvotim nga numri 111 e tutje, duke evituar kështu garën e pabarabartë dhe diskriminimin e kandidatëve brenda listave të subjekteve politike;

**Përfaqësimi i grave në trupat për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve** mbetet në nivele relativisht të ulëta. Zotimi i subjekteve politike i vitit 2015, për garantim të përfaqësimit të grave në trupat menaxhuese të zgjedhjeve në shkallën 40%, nuk është përmbushur as në këto zgjedhje.

Situata e rënduar me **pandeminë** nuk ishte parë si pengesë nga subjektet politike për zhvillimin e një **fushate zgjedhore** dinamike, përveç në komunat me shumicë serbe ku praktikisht nuk kishte fare fushatë. Megjithatë, pandemia kishte imponuar ndryshime në mënyrën e të bërit fushatë nga subjektet politike, të cilat një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve i kishin fokusuar në mediat tradicionale dhe rrjetet sociale, sidomos në periudhën e parafushatës. Ecjet në sheshe publike ishin formë e re, por mjaft e shprehur e të bërit fushatë, ndërsa është vërejtur një tendencë e shtuar e subjekteve politike për të **mos paralajmëruar aktivitetet zgjedhore** pranë institucioneve përkatëse.

Shumica e aktiviteteve të fushatës janë zhvilluar **pa përfillje të masave** kundër përhapjes së pandemisë, duke rezultuar me numër të shtuar të infeksioneve të reja disa javë pas fushatës. **Joefikasiteti i inspektorateve** komunale dhe Policisë për të shqiptuar gjoba në përputhje me legjislacionin, ka qenë faktor kontribuues në keqësimin e situatës në këtë drejtim.

Fryma e fushatës është manifestuar kryesisht përmes **narracionit të rivaliteteve politike** mes eksponentëve të subjekteve politike, e jo domosdoshmërisht përmes platformave të artikuluar politike, të cilat janë publikuar vetëm pak ditë para përmbjlljes së fushatës. Madje, janë evidentuar edhe raste të **gjuhës së urrejtjes** mbi baza partiake dhe gjinore.

Mungesa e kulturës së njëmendtë të konkurrencës politike ka rezultuar me mungesë të debateve dhe përballjeve mes kandidatëve të subjekteve politike, që mund të ketë limituar votuesit në përcaktimin e votës së tyre bazuar në orientime të qarta programore. Gjithsesi, është vërejtur një **motivim dhe entuziazëm i shtuar** qytetar për të marrë pjesë në aktivitete zgjedhore.



---

Përgjithësisht, edhe gjatë kësaj fushate, subjektet politike nuk u kanë ofruar **grave qasje të barabartë** në garën zgjedhore, në kundërshtim me ligjin për barazi gjinore, i cili proklamon përfaqësimin e barabartë.

Subjektet politike nuk treguan vullnet për transparencë sa i përket **financave dhe shpenzimeve** të tyre në fushatë edhe në këto zgjedhje. DnV-ja, gjashtë ditë para fillimit të fushatës kishte kërkuar nga subjektet politike që të tregojnë për shumat që ata planifikojnë t'i shpenzojnë në fushatë, mënyrën e financimit, udhëheqësit e fushatës dhe të tjera. Prej 25 subjekteve politike të cilave u është dërguar kjo kërkesë, vetëm tre prej tyre u përgjigjën pozitivisht.

**Përdorimi i resurseve publike**, financiare apo njerëzore, sidomos nga subjektet politike në pushtet, ka vijuar që si fenomen të shoqërojë aktivitetet e fushatës së subjekteve politike, ndonëse jo në përmasa sikur gjatë zgjedhjeve paraprake.

Fushata zgjedhore është paraprirë nga një **parafushatë intensive**, e cila është zhvilluar sidomos nëpër rrjetet sociale dhe mediat tradicionale. Gjetjet nga **monitorimi i mediave** tregojnë që televizionet kanë ofruar hapësirë të përafërt për subjektet e mëdha politike, ndërkaq më pak hapësirë për subjektet e vogla. Disa nga kanalet televizive kanë shfaqur edhe spote reklamuese, për të cilat ka mundur informacioni nëse kanë qenë të **sponsorizuara** ose jo.

Sa i përket **aspektit gjinor**, të dhënat tregojnë që kandidatët burra dhe kandidatet gra nuk janë paraqitur barazisht gjatë fushatës. Në matjet e bëra për kronikat zgjedhore, spotet e subjekteve politike, debatet politike dhe faqet zyrtare të subjekteve politike në rrjetet sociale, gratë kanë pasur dukshëm më pak mbulueshmëri në raport me kandidatët burra.

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë dashur 27 ditë për të **certifikuar rezultatet** e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Rezultatet e certifikuara kanë dallime domethënëse me rezultatet preliminare dhe ato përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja. Diskrepancë në rezultate është evidentuar për të paktën tri subjekte politike, të gjitha nga radhët e komuniteteve, dhe disa kandidatë, kryesisht për shkak të vendimeve të institucioneve gjyqësore, por edhe rinumërimeve. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar ndryshime edhe sa i përket renditjes së kandidatëve brenda listave të subjekteve politike.

Institucionet përgjegjëse për **trajtimin e ankesave dhe apeleve** lidhur me zgjedhjet, respektivisht Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Gjykata Supreme, kanë vepruar me profesionalizëm dhe në mënyrë të paanshme në trajtimin e ankesave dhe apeleve, duke respektuar të gjitha afatet e përcaktuara ligjore. Gjatë këtij procesi, PZAP ka trajtuar 775 lëndë, apo mesatarisht rreth 12 lëndë çdo ditë.

PZAP dhe Gjykata Supreme, me vendimet e tyre kanë **anuluar votat** e fituara nga disa subjekte të komuniteteve, në zonat me shumicë serbe, ku nuk ka përqendrim demografik të komuniteteve në fjalë, duke garantuar kështu përfaqësimin e drejtë të **vullnetit të komuniteteve**, bazuar në normat kushtetuese dhe praktikatat ndërkombëtare.

---

# 1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË

Ky raport paraqet vlerësimin e procesit zgjedhor, duke përfshirë periudhën përgatitore që nga shpallja e ditës së zgjedhjeve, punën e institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, mbarëvajtjen e operacioneve zgjedhore, ditën e votimit, proceset e numërimit dhe rinumërimeve, si dhe zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

Për periudhën e fushatës zgjedhore dhe monitorimin e mediave, nga DnV do të publikohen raporte të veçanta, të cilat bashkërisht përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm për procesin zgjedhor të 14 shkurtit.

Të gjeturat e këtij raporti bazohen në monitorimin e procesit, i zhvilluar nga Sekretariati i Demokracisë në Veprim sa i përket periudhës para ditës së zgjedhjeve si dhe trajtimit të kontesteve zgjedhore nga institucionet përkatëse, vëzhguesve afatshkurtër dhe ekipeve mobile gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe vëzhguesve të angazhuar për monitorimin e punës së Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve.

Demokracia në Veprim është rrjet i organizatave jo-qeveritare në Kosovë që promovon zgjedhje të lira dhe të drejta përmes monitorimit të procesit zgjedhor, edukimit të votuesve dhe avokimit për reformë zgjedhore. DnV ka angazhuar rreth mbi 650 vullnetarë për të vëzhguar në tërësi procesin zgjedhor për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 14 shkurt 2021.

Misioni i vëzhgimit është përbërë nga 16 vëzhgues të akredituar afatgjatë (LTO) të DnV-së, të cilët kanë përcjellë tubimet publike, takimet me grupet e shënjestruara, vizitat në shtëpi private dhe aktivitetet tjera të subjekteve politike në shtatë qendrat më të mëdha

të Kosovës<sup>1</sup>, duke përfshirë edhe zonat e banuara me shumicë serbe<sup>2</sup>. DnV ka monitoruar edhe mbledhjet e Komisioneve Komunale Zgjedhore.

Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka pasur të angazhuar mbi 600 vëzhgues afatshkurtër (STO), prej të cilëve 500 janë vendosur nëpër vendvotime sipas metodologjisë PVT. Ndërsa, mbi 100 vëzhgues tjerë janë angazhuar si ekipe mobile të cilat kanë ofruar asistencë për vëzhguesit statik, si dhe kanë përcjellë atmosferën e përgjithshme në Qendrat e Votimit (QV) dhe jashtë tyre. Të gjithë vëzhguesit kanë raportuar në baza në rregullta kohore për të gjitha zhvillimet lidhur me procesin zgjedhor, përfshirë mbarëvajtjen, daljen e votuesve dhe rezultatet preliminare të subjekteve politike.

Në Qendrën e Thirrjeve, DnV ka pasur të angazhuar rreth 50 vullnetarë tjerë, të cilët kanë mbledhur dhe procesuar të dhënat e marra nga terreni.

DnV po ashtu ka përcjellë nga afër edhe procesin e numërimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve me dy vëzhgues, në asistencë të të cilëve kanë qenë edhe ekipe tjera të ekspertëve nga Sekretariati i DnV-së.

Ekipi ligjor i DnV-së ka përcjellë edhe shqyrtimin e kontesteve zgjedhore, përfshirë ankesat dhe apelet në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa si dhe në Gjykatën Supreme.

Gjithashtu, DnV ka angazhuar 10 monitorues të mediave, të cilët kanë përcjellë mbulueshmërinë e ofruar nga mediat tradicionale dhe rrjetet sociale, për akti-

---

1 Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan dhe Gjakovë.

2 Me fokus në Graçanicë dhe Mitrovicën e Veriut.

---

vitetet e subjekteve politike në periudhën e fushatës zgjedhore, por edhe parafushatës.

Në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit afatshkurtër (STO) janë vendosur nëpër vendvotime të caktuara sipas metodologjisë *Parallel Vote Tabulation* (PVT), bazuar në një mostër të provuar statistikore, e cila është krijuar me asistencën e National Democratic Institute (NDI). Vëzhguesit janë trajnuar nga ekipe trajnerësh, të cilët praktikisht kanë kaluar në cikle të trajnimit të organizuara nga Sekretariati i DnV-së, lidhur me metodologjinë e vëzhgimit, mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, përgjegjësitë e akterëve relevantë, si dhe mënyrën e raportimit të të dhënave në platformën online.

STO-të kanë raportuar në tetë intervale të ndryshme kohore lidhur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve, parregullsitë apo incidentet e evidentuara, pjesëmarrjen në zgjedhje si dhe rezultatet e subjekteve politike. Të dhënat nga terreni janë raportuar në mënyrë elektronike në një databazë të krijuar nga DnV enkas për përpunimin e këtyre të dhënave. Të dhënat janë përpunuar dhe analizuar tutje në Qendrën e Thirrjeve të DnV-së nga ekipe të specializuara në fushat përkatëse, ndërsa pastaj janë përgatitur njoftimet për publikun, përkatësisht konferencat dhe komunikatat për media.

Pas ditës së zgjedhjeve, me anë të dy vëzhguesve dhe ekipeve tjera DnV-ja ka vëzhguar edhe punën e QNR-së, përkatësisht procesimin e të dhënave nga vendvotimet, proceset e rinumërimit, si dhe procesimin dhe numërimin e votave me kusht dhe atyre të ardhura nga jashtë vendit. Po ashtu, sa i përket kontesteve zgjedhore, DnV-ja ka përcjellë trajtimin e apeleve dhe ankesave në PZAP dhe në Gjykatën Supreme.

Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka pasur të angazhuar mbi 600 vëzhgues afatshkurtër (STO), prej të cilëve 500 janë vendosur nëpër vendvotime sipas metodologjisë PVT. Ndërsa, mbi 100 vëzhgues tjerë janë angazhuar si ekipe mobile të cilat kanë ofruar asistencë për vëzhguesit statik, si dhe kanë përcjellë atmosferën e përgjithshme në Qendrat e Votimit (QV) dhe jashtë tyre. Të gjithë vëzhguesit kanë raportuar në baza në rregullta kohore për të gjitha zhvillimet lidhur me procesin zgjedhor, përfshirë mbarëvajtjen, daljen e votuesve dhe rezultatet preliminare të subjekteve politike.

---

## 2. KONTEKSTI POLITIK

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka organizuar katër palë zgjedhje parlamentare, të gjitha zgjedhje të parakohshme, pa përfshirë edhe këto zgjedhje që janë të pestat në periudhë 10 vjeçare. Asnjë nga Qeveritë e formuara nuk arritën të përfundojnë mandatin 4 vjeçar, ndërsa aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese jo rrallë herë shërbyen si udhëzues për formimin e Qeverive të reja apo rrëzimin e tyre.

Qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti u formua në qershor 2020, pas votimit të suksesshëm të mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë paraprake të udhëhequr nga Albin Kurti nga Lëvizja Vetëvendosje, pjesë e së cilës ishte dhe vet LDK. Ishte aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i cili i hapi rrugën formimit të kësaj Qeverie me dhënien e vlerësimit se dekreti i Presidentit të atëhershëm Hashim Thaçi për Hotin mandatar ishte kushtetues. Ky dekret ishte sfiduar nga Lëvizja Vetëvendosje, e cila pretendonte që vendi duhet të shkonte në zgjedhje të reja dhe nuk mund të kishte mandatar të ri për formimin e Qeverisë.

Fati i kësaj Qeverie ishte ndërlidhur edhe njëherë me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në një tjetër kontestim të ngritur para këtij institucioni nga LVV, që kishte të bënte me votën e deputetit të dënuar Etem Arifi me vendim të formës së prerë të institucioneve gjyqësore, por edhe vet kushtetutshmërinë e zgjedhjes së Qeverisë 'Hoti'. Më 11 qershor 2020, 17 deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje parashtruan kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për zgjedhjen e Qeverisë 'Hoti' më 3 qershor, për shkak të pretendimeve për pavlefshmërinë e mandatit të deputetit Etem Arifi, i cili përbënte kushtimisht votën e 61-të për Qeverinë.

Me publikimin e aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese në 21 dhjetor, disa muaj pas parashtrimit të saj, zgjedhja e kësaj Qeverie u vlerësua të jetë bërë jo konform Kushtetutës, duke përcaktuar për të tepër që vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja të parakohshme parlamentare. Mospajtueshmëria me Kushtetutën, sipas vendimit, ndërlidhet me faktin se deputeti Etem Arifi, i cili kishte votuar 'për' zgjedhjen e Qeverisë, nuk ka pasur mandat të vlefshëm gjatë periudhës në fjalë, e si rrjedhojë, Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të deputetëve. Publikimi i aktgjykimin të plotë të Gjykatës i hapi rrugën u.d. të Presidentes Vjosa Osmani, që më 6 janar, të nxjerrë dekretin për shpërndarjen e Kuvendit dhe caktimin e datës së zgjedhjeve më 14 shkurt.

Gjatë periudhës së qeverisjes Hoti kishte zhvillime të shumta politike të cilat krijuan një klimë të përgjithshme të mungesës së stabilitetit politik. Qeveria nuk kishte shumicën e nevojshme në Kuvend për të shtyrë përpara programin e saj qeverisës dhe as ligjet që kërkonin shumicën e thjeshtë të deputetëve përfshirë ato që synonin rimëkëmbjen ekonomike në përballje me pandeminë COVID-19. Para publikimit të aktgjykimin të Kushtetueses, vendi veçse ndodhej në presion politik lidhur me zgjedhjen e Presidentit të ri të vendit, meqenëse përcaktimet kushtetuese qartazi flasin për afat maksimal prej 6 muajsh për ushtrimin e mandatit nga Ushtruesja e Detyrës së Presidentit.

Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë konfirmuan aktakuzat e para ndaj ish krerëve të UÇK-së përkatësisht ndaj ish Presidentit Hashim Thaçi, kreut të PDK-së, Kadri Veseli, anëtarit të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, si dhe anëtarit të LVV-së, Rexhep Selimi.

---

Qeveria Hoti nënshkroi Marrëveshjen e Uashingtonit proces ky që u njoh si normalizim ekonomik me Serbinë më 4 shtator të vitit 2020, në Shtëpinë e Bardhë, në prezencë të ish Presidentit Amerikan, Donald Trump. Ndonëse kjo marrëveshje pritej të nënshkruhej menjëherë me formimin e Qeverisë Hoti dhe heqjen e masave të reciprocitetit, aktakuzat e ngritura ndaj Presidentit Thaçi gjatë rrugës kur po udhëtonte drejt SHBA-ve, shtyn periudhën e arritjes së të njëjtës.

Pritshmëritë për ndryshim në qeverisje ishin prezentë veçanërisht pas arritjes së Marrëveshjes së Uashingtonit për shkak të mungesës së shumicës parlamentare që Qeveria Hoti kishte dhe nevojës për një shumicë të konsoliduar për të shtyrë përpara dhe procesin e dialogut Kosovë-Serbi nën ndërmjetësimin e BE-së. Takimet e rifilluara nga kjo Qeveri nën ndërmjetësimin e Emisarit të BE-së Miroslav Lajçak vunë në pah polarizimin brenda spektrit të gjerë politik por dhe fuqinë e cinguar vendimmarrëse të Kryeministrit Hoti në një qeveri kur partnerët e koalicionit rëndom mbanin qëndrime të kundërta. Përçarjet politike shkaktuar nga rrëzimi i Qeverisë në kohë pandemie vetëm 52 ditë pas zgjedhjes së të njëjtën me ish-aleatin e qeverisë LVV si dhe ish kandidaten për Kryeministres nga radhët e LDK-së Vjosa Osmani mbizotëruan gjithashtu diskutin politik. Ashtu siç u rikthye temat nacionale dhe të luftës si kundërpërgjigje ndaj aktakuzave të Dhomave të Specializuara.

Përkundër thirrjeve dhe kërkesave të shumta, sidomos nga shoqëria civile, për reformimin e sistemit zgjedhor me qëllim të adresimit të problemeve dhe mangësive të tij, në mungesë të vullnetit politik, polarizimit të spektrit politik, si dhe brishtësisë së shumicës parlamentare, ky proces nuk u iniciua fare.

Përkundër thirrjeve dhe kërkesave të shumta, sidomos nga shoqëria civile, për reformimin e sistemit zgjedhor me qëllim të adresimit të problemeve dhe mangësive të tij, në mungesë të vullnetit politik, polarizimit të spektrit politik, si dhe brishtësisë së shumicës parlamentare, ky proces nuk u iniciua fare.

### 3. KORNIZA LIGJORE

Sistemi zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme është i përcaktuar sipas Kushtetutës së Kosovës dhe disa ligjeve specifike që rregullojnë në tërësi procesin zgjedhor. Aktet normative të cilat rregullojnë procesin e organizimit, administrimit dhe mbarëvajtjes së zgjedhjeve janë Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, përfshirë edhe plotësim-ndryshimin e tij, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, rregullat zgjedhore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe rregulloret e punës së KQZ-së dhe PZAP-së.

Sistemi që aplikohet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës është sistem proporcional i përfaqësimit, me lista të hapura të kandidatëve nga subjektet politike. Republika e Kosovës është një zonë e vetme zgjedhore, ku subjektet politike garojnë për 120 ulëset e Kuvendit të Kosovës, prej të cilave 10 janë të garantuara për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin serb, ndërsa 10 të tjera janë të garantuara për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet tjera jo-shumicë, përfshirë 3 ulëse për komunitetin boshnjak, 2 për komunitetin turk, 1 për komunitetin rom, 1 për komunitetin ashkali, 1 për komunitetin egjiptian, 1 vend për komunitetin rom, ashkali ose egjiptian, bazuar në numrin më të madh të votave të fituara nga komuniteti përkatës, si dhe 1 për komunitetin goran. Subjektet që nuk deklarohen se përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë në vend garojnë faktikisht për 100 ulëse. Pragu zgjedhor për të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhje është 5%. Ndërsa, për subjektet politike të cilat garojnë për ulëset e garantuara nuk aplikohet fare prag zgjedhor.

Bazuar në aktet ligjore në fuqi, Kosova aplikon kuotë të dyfishtë gjinore. Kuota e parë aplikohet në listat e dorëzuara për certifikim nga subjektet politike, që parasheh që të paktën 30% e listës së secilit subjekt

politik duhet të jetë i përbërë nga gjinia më pak e përfaqësuar. E njëjta kuotë zbatohet edhe në ndarjen e ulëseve në Kuvendin e Kosovës.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në Republikën e Kosovës përcakton sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin, mbrojtjen e të drejtës për të votuar, kriteret për pranueshmërinë e votës, mirëmbajtja e listës së votuesve, regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike, përgjegjësitë dhe funksionimin e KQZ-së, organizimin dhe funksionimin e komisioneve komunale zgjedhore dhe këshillave të vendotimeve, rregullat për akreditimin e vëzhguesve, kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar, mbulimin e fushatës zgjedhore nga mediat, Kodin e mirësjelljes të subjekteve politike, kandidatëve dhe mbështetësve, procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve, si dhe aspekte tjera lidhur me procesin zgjedhor në Kosovë.<sup>3</sup>

Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon administrimin, shpenzimet, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin financiar të subjekteve politike para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore.<sup>4</sup> Më konkretisht, përmes këtij ligji specifikohen në detaje çështjet financiare dhe shpenzimeve të subjekteve politike, përfshirë këtu edhe kohën e zgjedhjeve. Ndër specifikat kryesore të këtij ligji janë rregullimi i aspekteve rreth statusit të subjektit politik, burimet financiare dhe materiale të subjekteve, forma e kontributeve për subjektet politike, fondi për mbështetjen e subjekteve politike që alokohet

3 Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 qershor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

4 Ligji Nr. 03/L-074 për Financimin e Subjekteve Politike në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 21 tetor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>

---

nga buxheti i shtetit dhe të ngjashme. Në veçanti, ky ligji rregullon edhe ndarjen e mjeteve financiare për fushat zgjedhore. Sipas nenit 10 të këtij ligji, për financimin e fushatës zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Kuvendi mund të ndajë mjete nga fondi me propozim të Qeverisë por jo më shumë se 0.05% të buxhetit të Kosovës. Mjetet për financimin e fushatës zgjedhore ndahen për subjektet politike të cilat marrin pjesë në zgjedhje ku 90% e mjeteve financiare ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvend, kurse 10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuara për zgjedhjet nga KQZ-ja.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës në një kapitull të tërë, i përbërë nga 11 nene lidhur me të drejtën e votimit, përcakton të gjitha veprat penale kundrejt procesit zgjedhor.<sup>5</sup> Disa nga veprat penale që sanksionohen me Kodin Penal janë: ndalimi ose pengimi i personit nga kandidimi në zgjedhje, pengimi i kandidatit nga aktivitetet e fushatës, pengimi i votuesit gjatë votimit ose ndikimi në vendim, ndërmjetësimi i ryshfetit për favor të votave, votimi ose tentativa për të votuar në emër të dikujt tjetër, shpërdorimi i detyrës zyrtare të stafit zgjedhor, votimi i dyfishtë, pengimi ose ndalimi i paligjshëm i procesit të votimit, shkelja e privatësisë në votim, falsifikimi i rezultateve, dëmtimi i dokumenteve të votimit dhe të tjera.

Legjislacioni sekondar, i cili zgjeron parimet e përfshira në ligjet që rregullojnë zgjedhjet, është miratuar nga KQZ-ja përmes rregullave zgjedhore me anë të së cilave rregullohen aspekte të caktuara të procesit zgjedhor. Gjithsej, KQZ-ja ka nxjerrë 21 rregulla zgjedhore. Po ashtu, KQZ ka të miratuara edhe 15 udhëzime administrative që adresojnë aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor, por edhe të funksionimit të brendshëm të KQZ-së.

Për zgjedhjet e 14 shkurtit, legjislacioni primar nuk ka pësuar asnjë ndryshim, ndërsa ai sekondar ka pësuar ndryshime të vogla, që ndërlidhen kryesisht me aspektin teknik të organizimit, administrimit dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor – me fokus lidhur me operacionin e votimit jashtë vendit.

Fillimisht, KQZ-ja kishte ndjekur praktikën e deritanishme, duke miratuar një udhëzues për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve si dhe Këshillat e Vendvotimeve lidhur me identifikimin e votuesve në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve. Udhëzimi obligon trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve që të pranojnë si të vlefshme vetëm dokumentet e lëshuara nga institucionet e Republikës së Kosovës, e të cilat kanë afat të vlefshëm, të parapara me nenin 90 të LZP.

Tutje, KQZ kishte plotësuar kuadrin e legjislacionit sekondar lidhur me votimin jashtë vendit, kur më 12 janar, kishte nxjerrë udhëzim administrativ lidhur me verifikimin e aplikacioneve të votuesve jashtë vendit, që përcaktonte numrin e thirrjeve telefonike, mënyrën e verifikimit dhe vendosjes nga Sekretariati i KQZ-së dhe të ngjashme. Ky udhëzim kishte pasuar vendimin e një dite më herët të KQZ-së për të njëjtën çështje.

Në këtë proces zgjedhor, si rezultat i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me votat e ardhura në kuadër të operacionit të votimit jashtë vendit si dhe përshtatshmërisë juridike të kandidatëve, është rikthyer praktika e mospranimit të votave të ardhura me vonesë, si dhe është përcaktuar pamundësia e garimit të kandidatëve të dënuar me vendim të formës së prerë gjatë tri viteve të fundit.

---

<sup>5</sup> Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare, 14 janar 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

---

## 4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, organi përgjegjës për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, si dhe shpalljen e rezultateve të tyre, është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në kryerjen e përgjegjësisë dhe funksioneve të tij, ky institucion kushtetues ndihmohet nga Sekretariati i KQZ-së.

Me qëllim të përgatitjes dhe administrimit të zgjedhjeve në mënyrë sa më efikase, në nivele komunale janë themeluar Komisionet Komunale Zgjedhore, të cilat funksionojnë në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Këto komisione janë të themeluara në secilën prej 38 komunave të Kosovës.

Grupat përgjegjëse për administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve janë Këshillat e Vendvotimeve, të cilat përbëhen nga pesë deri në shtatë anëtarë.

Ndërsa, pas përfundimit të ditës së zgjedhjeve, lokacioni ku zhvillohet procesi i numërimit të votave me kusht, votave nga jashtë, si dhe proceseve eventuale të rinumërimit është Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, e cila vepron sipas vendimeve të KQZ-së.

### 4.1 Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Që nga shpallja e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, deri në certifikimin e rezultateve përfundimtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka mbajtur gjithsej 28 mbledhje, 19 prej të cilave ishin mbajtur deri në ditën e zgjedhjeve. Marrë në përgjithësi, puna e KQZ-së ka qenë transparente, mirëpo pothuajse secili vendim i marrë është përcjellë me kontradikta dhe mospajtime mes anëtarëve të KQZ-së, në veçanti mes

anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryetares së KQZ-së, por jo vetëm. Ndryshe nga pothuajse cilado përbërje dhe proces tjetër zgjedhor, puna e KQZ-së është karakterizuar me politizim të pothuajse secilës pikë të rendit të ditës, duke rezultuar nganjëherë edhe me mostrajtim adekuat të tyre. Mospajtimet e theksuara mes anëtarëve, në shumë raste kanë pamundësuar mbarëvajtjen e mbledhjeve, duke bërë që shumica e mbledhjeve të ndërpriten.

Çështja e verifikimit të votave nga jashtë, certifikimi i kandidatëve për deputetë, afati për pranimin e votave ka qenë temat që kanë nxitur më së shumti debat mes anëtarëve, mospajtime këto që në shumë raste kanë përfunduar në akuza personale mes anëtarëve të KQZ-së.

Gjatë këtyre zgjedhjeve, puna e KQZ-së është afektuar edhe nga interferimet politike nga jashtë. Në një situatë të paprecedentë, më 23 janar, Ushtruesja e Detyrës së Presidentit kishte dalë me një konferencë për media, duke kërcënuar publikisht me veprime anëtarët dhe vet kryetaren e KQZ-së lidhur me çështjen e certifikimit të kandidatëve. Ngjashëm kishin vepruar edhe akterë tjerë të jashtëm të cilët në vazhdimësi kishin bërë presione të ndryshme ndaj KQZ-së, që kishin cenuar punën dhe pavarësinë e KQZ-së.

Edhe pse pothuajse të gjitha mbledhjet e KQZ-së janë paralajmëruar për vëzhguesit dhe palët tjera të interesit, në disa raste mbledhjet janë shtyrë pa paralajmërim. Në anën tjetër, dokumentet apo materialet kanë qenë rrallëherë të qasshme për publikun dhe palët e interesit. Në këtë drejtim, KQZ ka shënuar regres me pasurimin e faqes së saj zyrtare elektronike me dokumentet, respektivisht vendimet, të cilat janë trajtuar gjatë mbledhjeve.



---

Afatet kryesore të aktiviteteve zgjedhore për këto zgjedhje janë miratuar qysh në mbledhjen e parë të KQZ-së pas shpalljes së Ditës së zgjedhjeve. Disa prej këtyre afateve ishin ndryshuar, kryesisht si rezultat i garantimit të mbarëvajtjes së rregullt të procesit, apo edhe pamundësisë për t'i përmbyllur ato në kohë. Po ashtu, si rezultat i natyrës së parakohshme të zgjedhjeve, KQZ-ja kishte marrë vendim për shkurtimin e afateve për disa aktivitete zgjedhore.

KQZ menjëherë pas shpalljes së zgjedhjeve, kishte miratuar planin buxhetor prej 5 milionë e 578 mijë e 712 euro për organizim të zgjedhjeve, alokimi i të cilave është bërë pa vonesë nga ana e Qeverisë së Kosovës. Në ndërkohë, KQZ i kishte kërkuar Qeverisë edhe mjete shtesë në shumë prej 165 mijë e 850 euro, kërkesë kjo që kishte gjetur mbështetje nga ana e ekzekutivit.

Për dallim nga proceset paraprake zgjedhore, në këto palë zgjedhje KQZ-ja kishte marrë vendim që të marrë përsipër organizimin e tërësishëm të procesit zgjedhor në katër komunat veriore, duke mos përfshirë misionin e OSBE-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për sa i takon dokumenteve të vlefshme për identifikim të votuesve, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, kishte miratuar një udhëzues për KKZ-të dhe KVV-të, lidhur me dokumentet e vlefshme me të cilat mund të votohet. Sipas këtij udhëzimi, dokumentet me të cilat mund të votohet janë vetëm ato dokumente që janë të vlefshme deri në Ditën e Zgjedhjeve dhe jo edhe ato që kanë afat të skaduar. Sidoqoftë, në kundërshtim me këtë udhëzues, në një vendim krejt të pazakontë dhe ad-hoc, i cili ishte bazuar në një interpretim shumë të gjerë të ligjit, KQZ në mes të ditës së zgjedhjeve, konkretisht 8 orë pas fillimit të procesit të votimit, ka marrë vendim për lejimin e votimit me dokumente me afat të skaduar. Ky vendim ka ndikuar në rritjen e konfuzionit tek qytetarët dhe komisionerët dhe në esencë ka diskriminuar qytetarët të cilët para orës 15:00 nuk janë lejuar të votojnë me po këto dokumente. Në anën tjetër, KQZ, më datë 8 janar kishte marrë vendim edhe për mos përfshirjen e mbi 130 mijë personave në listën e votuesve për zgjedhjet e 14 shkurtit të cilët posedojnë vetëm dokumente të UNMIK-ut. Ky vendim është nxjerrë pasi që KQZ në të kaluarën kishte marrë vendim që obligonte trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve që të pranojnë si të vlefshme vetëm dokumentet e lësh-

uara nga institucionet e Republikës së Kosovës, të para para me nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte miratuar edhe dizajnin e fletëvotimit dhe dizajnin e broshurës së kandidatëve, të cilat vizuelisht ishin të njëjta me dizajnet e zgjedhjeve të kaluara. KQZ-ja për këto palë zgjedhje ka shtypur 1,617,200 fletëvotime apo 10% më pak se numri i votuesve të regjistruar. Kjo përqindje është relativisht më e lartë se zgjedhjeve të kaluara, kur ishin shtypur vetëm 7% më pak fletëvotime. KQZ kishte miratuar edhe formularët për përputhjen e të dhënave dhe rezultateve, si për rezultatet preliminare për subjektet politike, ashtu edhe për kandidatët. Për këta të fundit, KQZ kishte marrë vendim përkundër përplasjeve e mospajtimeve mes anëtarëve të KQZ-së, duke qenë se KQZ kishte vendosur që kandidatët e pa certifikuar të mos përfshihet fare në formularët e rezultateve të kandidatëve, përkundër kërkesës së anëtarëve të LVV-së që të veprohet ndryshe. Madje, KQZ kishte vendosur që rubrikat përkatëse të mos mbeten të hijezuara/shënuara, siç ishte propozuar, por që rubrikat të mos figurojnë fare, dhe renditja e kandidatëve të bëhet pa përfshirë numrat e kandidatëve të pa certifikuar. KQZ, në mbledhjen e mbajtur më 8 janar ka miratuar Strategjinë e Informimit Publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës,

Informimi dhe edukimi i votuesve nga KQZ ka shënuar përmirësim të ndjeshëm, si për nga kualiteti ashtu edhe nga mënyra e plasimit të informatave. Po ashtu, KQZ ka vijuar me bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe hisedarët tjerë në funksion të arritjes së një numri më të madh të publikut me produktet. Për shërbimet dhe produktet e dedikuara për informim të votuesve, KQZ kishte paraparë një buxhet të përafërt prej rreth 200 mijë eurosh. Ndër tjera, KQZ-ja kishte marrë vendim për miratimin e sloganit të këtyre zgjedhjeve "Voto për Kuvendin e Kosovës!".

Për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja ka angazhuar 17 mijë persona staf në Këshillat e Vendvotimeve. Si staf ndihmës, nga KKZ-të janë përfshirë mbi 9 mijë persona, ndërsa janë angazhuar rreth 300 anëtarë në 110 ekipet mobile që KQZ-ja ka pasur në dispozicion.

Më 2 mars, KQZ kishte marrë vendim për anulimin e rezultateve të dy vendvotimeve, në Vushtrri (2717B/01R)

dhe në Mitrovicë të Veriut (3805B/05R) për shkak të mospërputhjeve në mes të fletëvotimeve brenda kutisë së votimit dhe nënshkrimeve në LPV, për respektivisht 5 dhe 10 fletëvotime më shumë se nënshkrime, edhe pas rinumërimit të tyre.

#### **4.2 Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve**

Komisionet Komunale Zgjedhore janë organe, që sipas legjislacionit zgjedhor, janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të secilës prej 38 komunave në vend. Sipas përcaktimit ligjor, KKZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë përgjithësisht, me këtë numër që mund të rritet nëse numri i partive që kualifikohen për të qenë pjesë e KKZ-së është më i madh. Anëtarët përzgjidhen nga KKZ-ja bazuar në nominimet e subjekteve politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit, dhe mandati i të njëjtëve fillon brenda 15 ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve dhe përfundon 15 ditë pas certifikimit të rezultatit zgjedhor. Vendimet brenda KKZ-ve merren me aprovimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të pranishëm.

Kompetencat kryesore të KKZ-ve ndërlidhen me administrimin e zgjedhjeve brenda territorit të komunës së tyre, duke u fokusuar më së shumti në raport me shërbimin ndaj votuesve, si dhe përgatitjet teknike të organizimit të ditës së zgjedhjeve. Mes tjerash, KKZ-të ofrojnë informata për votuesit, nominojnë trajnerë për trajnimin e stafit zgjedhor, caktimin e anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve, lokacionet e qendrave të votimit dhe vendvotimeve, sfidimin dhe ndryshimin e listës përfundimtare të votuesve – respektivisht heqjen e personave të vdekur, pranimin e materialeve të ndjeshme dhe jo të ndjeshme nëpër depot e tyre, e të tjera të kësaj natyre.

Përbërja e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) nuk ka paraqitur çështje mbi të cilën janë shfaqur pakënaqësi nga subjektet politike të përfshira në proces, me përjashtim të disa rasteve nga subjektet politike të komuniteteve, të cilat kanë kërkuar përfaqësim në disa komuna, ndonëse në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Vendimi për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve ishte marrë më 15 janar, brenda afatit të paracaktuar me planin operacional të zgjedhjeve, i cili kishte paraparë 16 janarin si ditën e fundit. Sidoqoftë, vlen të përmendet

Sipas të dhënave të ofruara nga SKQZ, për administrimin e ditës së zgjedhjeve, janë angazhuar gjithsej 16,525 persona, prej të cilëve 2,564 ishin kryesues, 12,263 ishin anëtarë të KVV-ve, përkatësisht komisionerë, ndërsa 1,698 ishin staf rezervë. Shikuar edhe nga aspekti i numrit të përgjithshëm të vendvotimeve, i bie se janë angazhuar mesatarisht 6.9 persona për secilin vendvotim në nivel vendi.

që në këtë drejtim, ka ekzistuar një lëshim nga ana e KQZ-së, e cila në vendimin për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore kishte përcaktuar 12 janarin si ditën e fundit për emërimin e KKZ-ve, deri sa plani i detajuar operacional ka datë të fundit datën 16 janar.

Për operacionin e krijimit dhe trajnimit të këshillave të vendvotimeve, KQZ kishte paraparë gjithsej 13 ditë. Në kuadër të këtij operacioni, ishte paraparë edhe krijimi i KVV-ve për ekipet mobile, përkatësisht ato të votimit me kusht, duke përfshirë edhe votimin e personave të infektuar apo të izoluar si pasojë e COVID-19. Përbërja e kryesuesve dhe anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit ka përfshirë subjektet politike të cilat janë certifikuar për të garuar në zgjedhjet e 14 shkurtit, duke reflektuar përbërjen e KKZ-ve në nivel të komunës përkatëse.

Kurse, në kuadër të ekipeve mobile, KQZ ka angazhuar gjithsej 200 ekipe të tilla në nivel vendi, duke përfshirë secilën komunë, prej të cilave 96 ekipe mobile ishin për votimin e personave me nevoja të veçanta, ndërsa 104 ekipe të tjera për votimin e personave të infektuar apo të izoluar nga COVID-19.

Me qëllim të trajnimit të stafit zgjedhor, KQZ-ja kishte angazhuar gjithsej 274 persona nga KKZ-të e secilës komunë. Në kuadër të këtyre trajnerëve, është pozitiv fakti që më shumë se gjysma e tyre, gjegjësisht 54% janë gra.

Në anën tjetër, Këshillat e Vendvotimeve janë trupa të përkohshme për administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve. KVV-të përbëhen nga anëtarë të propozuar nga subjektet politike, OJQ-të, dhe organizatat qytetare, bazuar në strukturën e anëtarëve të KKZ-së në atë komunë. Anëtarët e KVV-së duhet të jenë votues të komunës përkatëse ku ata propozohen. Emërimi i secilit anëtar në KVV është i kushtëzuar me dhënien e betimit dhe nënshkrimin e Kodit të Sjelljes siç parashihet me rregull të KQZ-së, siç përcaktohet në nenin 81 të LZP.

Për krijimin e këshillave të vendvotimeve, si operacion zgjedhor, KQZ kishte paraparë një periudhë 13 ditore, ku ishin përfshirë veprime, të tilla si dërgimi i ftesave tek subjektet politike për propozim të KVV-ve, pranimin e propozimeve nga subjektet tek KKZ-të, pranimin e propozimeve nga KKZ tek SKQZ, verifikimin e këtyre personave, emërimin ose refuzimin e tyre nga KQZ, si dhe procedura tjera lidhur me ekipet e komisionerëve për votimin e personave me nevoja të veçanta dhe personave të infektuar apo të izoluar nga COVID-19.

Sipas të dhënave të ofruara nga SKQZ, për administrimin e ditës së zgjedhjeve, janë angazhuar gjithsej 16,525 persona, prej të cilëve 2,564 ishin kryesues, 12,263 ishin anëtarë të KVV-ve, përkatësisht komisionerë, ndërsa 1,698 ishin staf rezervë. Shikuar edhe nga aspekti i numrit të përgjithshëm të vendvotimeve, i bie se janë angazhuar mesatarisht 6.9 persona për secilin vendvotim në nivel vendi.

Në këto zgjedhje, SKQZ si dhe organet tjera për menaxhimin e zgjedhjeve në nivel lokal, kanë hasur në vështirësi me ndryshimet e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve, kryesisht për shkak të situatës me pandeminë.

Ndërsa, sa i përket stafit teknik të QV-ve, për ditën e zgjedhjeve janë angazhuar gjithsej 6,070 persona, prej të cilëve, 893 ishin menaxherë të QV-ve, 1,960 zyrtarë të tavolinës ndihmëse, 1,556 asistentë të QV-ve, 95 punëtorë fizik dhe 1,566 vozitës.

Proporcioni i stafit zgjedhor është i bazuar në madhësinë e komunave përkatëse, respektivisht të numrit të qendrave të votimit dhe vendvotimeve të tyre.

### 4.3 Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

QNR-ja, sipas përcaktimit ligjor, është lokacioni ku pranohet materiali zgjedhor nga vendvotimet, procedohen formularët e zgjedhjeve, numërohen votat me kusht, votat me postë dhe fletëvotimet tjera sipas kërkesës së KQZ-së apo PZAP-së<sup>6</sup>. Organizimi, funksionimi dhe procedurat e numërimit të QNR-së janë të përcaktuara në Rregullën Zgjedhore Nr. 06/2013 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Për zgjedhjet e 14 shkurtit, QNR-ja ka operuar me dy nivele të stafit të angazhuar – 685 persona si staf ditor, si dhe 78 persona si staf menaxhues. QNR ka operuar kryesisht me dy ndërrime pune, me përfshirje të javës së parë pas ditës së zgjedhjeve ku puna është zhvilluar edhe në tri ndërrime. Për shkak të dinamikës së shtuar të punës, QNR ka operuar me deri në 45 tavolina numërimi për secilin ndërrim, që i bie brenda një dite janë zhvilluar procese të numërimit apo rinumërimit në 90 tavolina. Fillimisht, numri i tavolinave të numërimit ishte më i vogël, por pas kërkesave të DnV-së dhe palëve tjera, ishte vendosur që numri i tavolinave të rritet deri në 45 sosh, duke kontribuar në procesimin dukshëm më të shpejtë të rezultateve të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre.

Puna në QNR ka qenë përgjithësisht e hapur dhe transparente për publikun. Sidoqoftë, pas rrjedhjes së një video-incizimi ku disa të punësuar të QNR-së dyshohesh se ishin përfshirë në skema të manipulimit zgjedhor – që u vërtetuan pas rinumërimit – është minuar ndjeshëm besimi i publikut në punën e këtij institucioni. Ndonëse numri i vendvotimeve të rinumëruara është dukshëm më i ulët se në zgjedhjet e vitit 2019, sërish, rinumërimi i rreth 700 kutive apo 29% e numrit të përgjithshëm të vendvotimeve, si dhe tërë votave me kusht dhe atyre me postë për një subjekt politik, është mjaft i

<sup>6</sup> Neni 3, Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 qershor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

lartë dhe shpërfaq problematika serioze në procesin e numërimit dhe reflektimit real të vullnetit qytetar.

Të gjitha subjektet politike, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat kanë pasur të drejtën e dërgimit të vëzhguesve në QNR, në proporcion me numrin e tavolinave në të cilat është zhvilluar numërimi apo rinumërimi. Sipas raporteve të QNR-së, në secilin ndërrim kanë qenë të pranishëm rreth 100 vëzhgues nga subjektet politike dhe organizatat tjera.

Në këto zgjedhje, QNR-ja ka qenë e angazhuar në një dinamikë më të shtuar të punës ngjashme me proceset e kaluara zgjedhore, përjashtuar zgjedhjet e vitit 2019 kur ishin rinumëruar pothuajse të gjitha vendvotimet. Ky proces zgjedhor është shoqëruar me probleme gjatë numërimeve, si në vendvotime, e kësaj here madje edhe në QNR. Me një trend të ngjashëm sikur proceseve para-prake, edhe kësaj here një numër i konsiderueshëm i vendvotimeve nuk kanë arritur t'a kalojnë auditimin e formularëve të rezultateve (FPR dhe FRK) në QNR, për shkak të mospërputhjeve mes formularëve dhe gjendjes faktike në kuti të votimit. Fillimisht, ishin rinumëruar 12 vendvotime nga karantina e QNR-së. Tutje, nga auditimi i vendvotimeve në nivel vendi, ishte marrë vendim për rinumërimin e 494 vendvotimeve. Arsyet kryesore për mos kalimin e auditimit, përkatësisht rinumërimin e këtyre vendvotimeve ishin mospërputhjet mes votave të subjektit politik dhe kandidatëve – ku subjekti kishte më pak ose nuk kishte fare vota, ndërsa kandidatët po, apo kur subjekti kishte vota ndërsa kandidatët jo; gabimet dhe tejkallimet e tolerancës së mospërputhjes në FPR; gabimet në bartjen e votave të subjekteve politike; si dhe gabimet tek formularët e rezultateve të kandidatëve. Shtrirja e vendvotimeve të rinumëruara në nivel vendi ishte gati se proporcionale me numrin e vendvotimeve, pa ndonjë komunë apo rajon me përmasa më të theksuara.

Pas përmbylljes së rinumërimit, gjatë verifikimit të tyre, janë rinumëruar sërish 58 vendvotime tjera, duke e çuar numrin e përgjithshëm të vendvotimeve të rinumëruara me vendim të KQZ-së në plot 552 vendvotime, apo mbi 23% të numrit të përgjithshëm të vendvotimeve. Ndërsa, nëse përfshihen edhe vendvotimet në karantinë, atëherë numri i përgjithshëm i vendvotimeve të rinumëruara është 564 sosh.

Pas apeleve të subjekteve politike, përkatësisht kandidatëve të tyre pranë PZAP-së, deri më 8 mars ishte ven-

dosur për rinumërimin e 134 vendvotimeve, kryesisht për shkak të parregullsive me votat e kandidatëve brenda listave. Përveç tyre, po atë ditë, me rekomandim të QNR-së KQZ kishte marrë vendim për rinumërimin edhe të shtatë vendvotimeve tjera, në të cilat ka pasur qasje personi i përfshirë në një video-incizim i cili pretendohet se shpërfaq një skemë të falsifikimit dhe manipulimit të rezultateve të kandidatëve nga stafi i QNR-së.

Pas rinumërimit të pjesshëm 134 vendvotimeve sipas vendimit të PZAP-së, është evidentuar se 19 prej tyre kanë pasur probleme, përkatësisht fletëvotime të subjekteve tjera, andaj të njëjtat ishin rinumëruar në tërësi.

Numri i përgjithshëm i vendvotimeve të rinumëruara gjatë këtyre zgjedhjeve është 698 sosh, apo rreth 30% nga gjithsej 2,382 vendvotime në nivel vendi. Ndërsa, përpos tyre janë rinumëruar të gjitha votat me kusht dhe votat nga jashtë vendit për subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

#### 4.4 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

Bazuar në planin operacional si dhe vendimin për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore, të miratuara nga KQZ-ja, periudha për aplikim për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, ishte caktuar të jetë prej 8 deri më 16 janar. Ndërsa, periudha për deklarimin për koalicionet e partive politike ishte caktuar prej 8 deri më 12 janar. Për koalicione, brenda afatit të paraparë kishin aplikuar vetëm dy subjekte politike, që të dyja nga komunitetet: Koalicioni VAKAT, i përbërë nga partitë politike Demokratska Stranka Bosnjaka (DSB) dhe Demokratska Stranka Vatan (DSV) dhe Koalicioni ZAJENO, i përbërë nga partitë politike Pokret za Gora (PG) dhe Gradanska Inicijativa Gore (GIG). Kurse, për certifikim si subjekte politike kishin aplikuar gjithsej 28 subjekte, përfshirë dy koalicionet e sipërpërmendura, si dhe pesë iniciativa tjera qytetare.

Në ndarjen sipas përkatësisë etnike, respektivisht komuniteteve që synojnë të përfaqësojnë subjektet politike, shtatë subjekte politike janë nga komuniteti shqiptar, pesë nga komuniteti boshnjak, katër nga komuniteti rom, nga tri subjekte komuniteti serb dhe komuniteti ashkali, si dhe nga dy subjekte politike komuniteti egjiptian, komuniteti turk dhe komuniteti goran.

Komuniteti	Parti politike	Koalicion	Iniciativë qytetare	Gjithsej
<b>Shqiptar</b>	7	0	0	7
<b>Serb</b>	1	0	2	3
<b>Rom</b>	2	0	2	4
<b>Ashkali</b>	3	0	0	3
<b>Egjiptian</b>	2	0	0	2
<b>Boshnjak</b>	3	1	1	5
<b>Turk</b>	2	0	0	2
<b>Goran</b>	1	1	0	2
<b>Gjithsej</b>	21	2	5	28

**TABELA 1** Subjektet politike të certifikuara për të marrë pjesë në zgjedhje, sipas etnisë

Më së shumti kandidatë janë propozuar nga subjektet politike të komunitetit shqiptar, me gjithsej 580 kandidatë, pasuar nga subjektet e komunitetit boshnjak me 145 kandidatë, subjektet e komunitetit ashkali me 119 kandidatë, subjektet e komunitetit egjiptian me 79 kandidatë, subjektet e komunitetit rom me 60 kandidatë, subjektet e komunitetit turk me 38 kandidatë, subjektet e komunitetit goran me 32 kandidatë, si dhe subjektet e komunitetit serb me 28 kandidatë.

Në kuadër të listave të dërguara nga këto 28 subjekte politike, kishin aplikuar për regjistrim fillimisht gjithsej 1,081 kandidatë. Prej tyre, 719, përkatësisht 66.5% ishin burra, ndërsa 362, përkatësisht 33.5% ishin gra. Ndërsa, pas kërkesave të subjekteve politike për tërheqjen e disa kandidatëve të tyre, numri i kandidatëve kishte rënë në 1,075.

Në këto zgjedhje, KQZ, bazuar edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin nr. KO95/20, kishte rikthyer praktikën e verifikimit të kandidatëve e subjekteve politike për deputetë. Madje, KQZ-ja kishte zhvilluar procedurë verifikimi për të gjitha kategoritë ligjore, lidhur me papërshtatshmërinë e kandidatëve për

deputetë, duke dërguar shkresa të veçanta për gjashtë institucione, përfshirë Policinë e Kosovës, Ministrinë e Mbrojtjes, Agjencinë së Kosovës për Inteligjencë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parash-tresa.

Sipas njoftimeve zyrtare të KQZ-së, vetëm nga KGJK kanë marrë njoftim për 47 kandidatë, të cilët janë shpallur fajtorë për vepër penale me vendim të shkallës së prerë të gjykatave, në tri vitet e fundit. Sidoqoftë, përkundër njoftimit, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim kishte dhënë rekomandim për certifikimin e 28 subjekteve politike dhe të gjithë kandidatëve të tyre, ndonëse në shkresën zyrtare, ZRPPC kishte treguar se ka hasur në vështirësi për të pasur qëndrim të qartë në lidhje me zbatimin e germës "q" të nenit 29 të LZP. Ky rekomandim kishte ngjallur debate të shumta dhe tensionim të situatës mes anëtarëve të KQZ-së. Në fakt, kjo mbledhje ka qenë e vetmja mbledhje, gjatë zhvillimit të së cilës ka pasur forca të shtuara policore jashtë objektivit të KQZ-së. Me kërkesë të kryetares, fillimisht mbledhja ishte shtyrë për disa orë, me qëllim

---

të sigurimit të materialeve mbështetëse për rekomandimin e ZRPPC-së. Gjithashtu, ishin kërkuar sqarime lidhur me shkresat për korrigjimin e listave zgjedhore, përkatësisht zëvendësimit të kandidatëve. Pas rifillimit të mbledhjes, kishin vazhduar polemikat mes anëtarëve të KQZ-së. Fillimisht, me shumicën e votave të anëtarëve ishte vendosur që votimi për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre të bëhet veç e veç, dhe jo në pako siç ishte propozuar nga Zyra. Në mungesë të 2/3 të votave të nevojshme për certifikim, listat e subjekteve politike NISMA, Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës dhe Partia e Ashkalinjve për Integrim nuk u certifikuan. Të gjitha subjektet tjera politike dhe kandidatëve të tyre u certifikuan. Duke qenë se në zgjedhjet paraprake parlamentare, AAK dhe NISMA nuk kanë qenë subjekte politike parlamentare (kanë garuar në koalicion), për të certifikimin e të njëjtave u votua ndaras, meqë rast AAK mori votat e nevojshme për t'u certifikuar si subjekt politik, ndërsa NISMA (për shkak të insistimit për tu votuar bashkërisht me listën e kandidatëve) nuk u certifikua.

Sa i përket çështjes së vlefshmërisë së aplikimit të verifikimit të kandidatëve, me anë të një votimi unanim, KQZ vendosi që periudha tre vjeçare e verifikimit të llogaritit në ditën e certifikimit dhe jo në ditën e shpalljes së zgjedhjeve.

Për shkak të mos certifikimit të listave të kandidatëve në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ishin parashtruar gjithsej 9 ankesa nga 7 subjekte politike.

Vendimet e PZAP-së lidhur me këto ankesa ishin publikuar më 26 janar. Në kuadër të 7 vendimeve të publikuara, PZAP ka vërtetuar vendimet e KQZ-së për moscertifikimin e 28 kandidatëve që kanë pasur probleme me përshtatshmërinë juridike në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ndërsa, PZAP kishte certifikuar listat e mbetura të kandidatëve të subjekteve politike. Po ashtu, në kuadër të vendimit ishte përcaktuar që subjektet politike nuk mund të zëvendësojnë kandidatët që nuk janë lejuar të marrin pjesë në garën zgjedhore, duke u thirrur në konsumimin e afateve përkatëse të caktuara nga KQZ-ja, respektivisht Zyra.

Lidhur me afatin e vlefshmërisë së aplikimit të kriterit të përshtatshmërisë juridike, PZAP kishte përcaktuar

që afati duhet të llogaritet duke filluar nga data e aktgjykimit penal të formës së prerë për secilin kandidat, deri në ditën e shpalljes së zgjedhjeve.

Pesë subjekte politike kishin ushtruar të drejtën e ankesës edhe pranë Gjykatës Supreme lidhur me moscertifikimin e kandidatëve. Gjykata Supreme, lidhur me seancat e mbajtura më 28 janar, më 29 janar kishte publikuar aktgjykimet përkatëse. Sipas tyre, Gjykata Supreme kishte ndryshuar pjesërisht vendimet e PZAP-së lidhur me moscertifikimin e kandidatëve të subjekteve politike që kanë probleme me ligjin. Gjegjësisht, Gjykata kishte konfirmuar se personat e dënuar me vendim të formës së prerë brenda tre viteve të fundit nuk mund të jenë pjesë e listave zgjedhore. Ndërsa, Gjykata kishte shprehur dilema lidhur me vlerësimet e PZAP-së për epërsinë e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ndaj Kodit Penal, por bazuar edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, kishte vendosur që të mos certifikohen kandidatët në fjalë.

Gjykata Supreme kishte përcaktuar po ashtu se llogaritja e afatit tre vjeçar lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve duhet të bëhet duke ju referuar datës së aktgjykimit penal të formës së prerë për secilin kandidat veç e veç, deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, duke u mbështetur edhe nenin 45 të Kushtetutës.

Pas vendimeve të instancave gjyqësore, numri i kandidatëve të certifikuar kishte rënë në gjithsej 1,052, prej të cilëve 359, apo 34%, ishin gra.

Sidoqoftë, DnV vlerëson që Gjykata Supreme, përkatësisht PZAP-ja, është dashur që të kërkojnë nga subjektet politike që t'i rirëndisin kandidatët e mbetur, në rast të mos certifikimit të kandidatëve të caktuar, me qëllim të evitimit të situatave ku komisionerët mund të gabojnë gjatë transferimit të rezultateve të kandidatëve nga fletët e punës tek formularët për rezultatet e kandidatëve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, edhe për procesin zgjedhor të 14 shkurtit, ka ndjekur praktikën e nisur në vitin 2019 për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim nga numri 111 e tutje, duke evituar garën e pabarabartë mes kandidatëve brenda listave të subjekteve politike.

**Shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim ishte hedhur më 1 shkurt 2021. Bazuar në të, renditja e subjekteve politike në fletëvotim ishte si vijon:**

**IRDK 111, KDTP 112, KOALICIJA VAKAT 113, YTHP 114, GI-SPO 115, LpB 116, PRBEK 117, SDS 118, SL 119, PB 120, NISMA 121, KOALICIJA ZAJENO 122, LPRK 123, RI 124, SDU 125, KNRP 126, LËVIZJA VETËVENDOSJE 127, PDAK 128, UZ-AH 129, PAI 130, NDS 131, LDK 132, NAŠA 133, PDK 134, AAK 135, PLE 136, JGP 137 dhe FJALA 138.**

#### **4.5 Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve**

Lista preliminare e votuesve, që është bazuar në ekstraktin e parë të Regjistrimit Qendror Civil, të ofruar nga Agjencia për Regjistrim Civil, ka përfshirë 1,869,662 votues.

Sipas planit operacional të KQZ-së, votuesve iu ishte dhënë afat prej vetëm tre ditësh, në periudhën 25 deri më 27 janar. Ky afat i shkurtër ka mundur të ketë ndikim që qytetarët të mos kenë hapësirën e nevojshme kohore për të sfiduar listën. Ndërsa, sipas kërkesës së KQZ-së drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 15 janar lidhur me verifikimin e 149 votuesve, prej të cilëve 116 ishin hequr nga LPV.

KQZ ka avancuar ndjeshëm me pastrimin e listave zgjedhore, meqë në këto zgjedhje, janë hequr nga lista mbi 130 mijë persona, apo gati rreth 10% e numrit të përgjithshëm të votuesve. Lista Përfundimtare e Votuesve ka përfshirë gjithsej 1,794,862 votues, apo gjithsej 143,006 votues më pak se në zgjedhjet e kaluara të vitit 2019. Në kuadër të personave të hequr nga Lista Përfundimtare e Votuesve, 122,421 ishin votues të cilët kanë poseduar vetëm dokumente të identifikimit të UNMIK-ut, bazuar në një vendim të marrë nga KQZ-ja më 8 janar për heqjen e këtyre personave, si dhe 11,086 persona tjerë të cilët sipas bazës së shënimeve të Departamentit të Pensioneve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, janë hequr nga ske-

mat pensionale për shkak se kanë vdekur. Të dhënat e këtyre personave janë konfirmuar edhe nga zyrtarët komunalë zgjedhor, bazuar në një vendim të miratuar nga KQZ. Në heqjen e personave të vdekur nga lista e votuesve, kontribut të madh kanë dhënë edhe KKZ-të e komunave përkatëse.

Në këto zgjedhje, për shkak edhe të numrit të madh të lindjeve në periudhën pas luftës, ajo siç njihet ndryshe si '*baby boom*', të drejtën e votës për herë të parë, pas rreth 1 viti e gjysmë nga zgjedhjet e fundit, e kanë fituar një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, respektivisht 59,631 sosh. Prej tyre, 49,198 janë votues që kanë arritur moshën 18 vjeç deri në ditën e zgjedhjeve, ndërsa 10,433 votues tjerë nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve në zgjedhjet e vitit 2019, të cilët janë regjistruar në Regjistrin Civil Qendror midis dy palë zgjedhjeve, apo votues që kanë ndërruar adresë në komuna të ndryshme.

Për zgjedhjet e 14 shkurtit, votuesit kanë mundur të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës në gjithsej 888 Qendra të Votimit, respektivisht në 2,382 vendvotime. Krahasuar me zgjedhjet paraprake, ka pasur shtatë QV më pak, kurse 165 vendvotime më pak. Numri i reduktuar i vendvotimeve ka ardhur kryesisht si rezultat i heqjes së një numri të konsiderueshëm të votuesve nga LPV. Edhe në këto zgjedhje, KQZ ka ndjekur praktikën e rritjes së numrit maksimal të votuesve që mund të ndodhen në listat e votuesve, nga 750 në 950.

Me qëllim të informimit të votuesve lidhur me qendrën e votimit ku ata mund të ushtrojnë të drejtën e votës, apo për të kërkuar ndryshimin e saj, KQZ ka caktuar një afat 11 ditor, në periudhën 17-27 janar, si periudhë të shërbimit të votuesve. Edhe kësaj here, ky shërbim është treguar efikas, meqenëse janë regjistruar rreth 300 mijë shfletime të faqes elektronike të KQZ-së. Në këto zgjedhje, ka pasur një rritje e numrit të votuesve që kanë kërkuar ndërrimin e qendrave të tyre të votimit, me mbi 7 mijë aplikacione të pranuar, prej të cilave 4,096 ishin përmes ueb-aplikacionit, ndërsa pjesa tjetër përmes zyrave të komisioneve komunale zgjedhore. Nga këto kërkesa, 6,550 janë aprovuar, ndërsa 762 janë refuzuar, kryesisht për shkak të mos dëshmimit të identitetit nga votuesi.

#### 4.6 Votimi jashtë vendit

Operacioni i votimit jashtë Kosovës, që njihet ndryshe si votimi me postë, ka qenë sërish një nga operacionet më të diskutuara të këtij procesi zgjedhor. Madje, votimi jashtë vendit, përpos se ka ngjallur polemika mes akterëve të përfshirë në proces, është kthyer në pikë përplasje mes anëtarëve të KQZ-së, duke qenë një prej arsyeve të ndërprerjes së një numri të konsiderueshëm të mbledhjeve të KQZ-së. Gjithashtu, pikërisht për shkak të kësaj çështje, KQZ, e në veçanti kryetarja e saj, janë atakuar vazhdimisht nga palë të ndryshme, duke ndikuar edhe punën e këtij institucioni.

Periudha e aplikimit për regjistrim si votues jashtë vendit ishte vetëm 9 ditë, në periudhën 13-21 janar, deri në orën 18:00 sipas orës lokale të Kosovës. Sidoqoftë, përkundër afatit të shkurtër, dhe përtej pritshmërive, në këtë periudhë janë pranuar gjithsej 175,273 aplikacione, 99% prej të cilave nëpërmjet e-mail adresave të hapura nga KQZ. Sidoqoftë, pas verifikimit të aplikacioneve, sipas të dhënave të KQZ-së, 45 mijë aplikacione janë larguar si dublikate, duke e sjellë numrin përfundimtar në 130,168 aplikacione. Në kuadër të këtyre aplikacioneve, janë aprovuar si të suksesshme në kuptim të vlerësimit të zotësisë juridike 102,100 prej tyre, ndërsa janë refuzuar 28,068 – shumica dërrmuese e së cilave për shkak se votuesit kanë dërguar formularin pa bashkëngjitur dokumente që dëshmojnë identitetin, apo që përmbushin ndonjë prej dëshmive të fitimit të drejtës së votës, si dhe aplikacionet kanë qenë të panënshkruara.

Aplikacionet për votim jashtë vendit janë pranuar nga gjithsej 67 shtete, prej të cilave prijnë Gjermania (43,049) dhe Zvicra (26,686), nga ku kanë ardhur mbi 70% e të gjitha aplikacioneve. Ajo çfarë bie në sy në këto zgjedhje është një rënie drastike e aplikacioneve të dërguara nga Serbia, me vetëm 160 aplikacione të votuesve të aprovuara.

Për administrimin e operacionit të votimit jashtë vendit, me qëllim të rritjes së integritetit të procesit zgjedhor, më 11 janar, KQZ kishte marrë vendim për verifikimin përmes telefonit të aplikacioneve për regjistrim në periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës.<sup>7</sup> Një ditë pas, ky vendim ishte pasuar me nxjerrjen e një udhëzimi administrativ, që përcaktonte numrin e thirrjeve telefonike, mënyrën e verifikimit dhe vendosjes nga Sekretariati i KQZ-së dhe të ngjashme.<sup>8</sup>

Vendimi i KQZ-së për verifikimin e aplikacioneve ishte kundërshtuar nga një pjesë e publikut si dhe nga anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ. Këta të fundit, si dhe një organizatë jo-qeveritare vendore kishin parashtruar ankesa në PZAP dhe Gjykatën Supreme, duke kërkuar anulimin e këtij vendimi dhe udhëzimit administrativ, mirëpo që parashtruesat ishin refuzuar dhe ato kishin mbetur në fuqi.

Rreth 15% e numrit të aplikacioneve të regjistruara suksesshëm për votim jashtë vendit, apo gati 14 mijë sosh, kanë qenë votues të cilët nuk kanë pasur fare shtetësi të Kosovës, apo kanë aplikuar me dokumente të UNMIK-ut. Të njëjtit, nuk do të mund të votojnë në mënyrë të rregullt për zgjedhjet në territorin e Kosovës, meqenëse jo vetëm që nuk mund të votojnë ata që nuk kanë dokumente të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Kosovës, por edhe votuesit që kanë dokumente të Kosovës, por me afat të skaduar, u pamundësohet votimi nëpër vendvotime.

Për përmbylljen e procesit të verifikimit të aplikacioneve të votimit jashtë vendit, KQZ ka rekrutuar një numër

<sup>7</sup> Për më shumë, shih Vendimin për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosovës. I qasshëm në: [https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/42-2021-Vendim-per-verifikimin-e-aplikacioneve\\_11-01-2021\\_1\\_al.pdf](https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/42-2021-Vendim-per-verifikimin-e-aplikacioneve_11-01-2021_1_al.pdf)

<sup>8</sup> Për më shumë, shih Udhëzimin Administrativ Nr.01/2021 për Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Votim Jashtë Kosovës. I qasshëm në: [https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/59-2021-Vendim-per-udhezim-nr-01-2021\\_12-01-2021\\_1\\_al.pdf](https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/59-2021-Vendim-per-udhezim-nr-01-2021_12-01-2021_1_al.pdf)



të konsiderueshëm të personave si staf jo-permanent. Vetëm për verifikimin e aplikacioneve janë angazhuar gjithsej 150 persona. Tutje, janë angazhuar edhe 330 persona të tjerë, që kanë punuar në tri ndërrime për vlerësimin e zotësisë juridike të aplikuesve. Në kuadër të një lloj qendre të thirrjeve, e cila ishte krijuar nga KQZ me qëllim të zbatimit të udhëzimit administrativ për verifikimin e aplikacioneve, janë angazhuar gjithsej 110 persona, që kanë operuar në dy ndërrime. Përveç burimeve njerëzore, për kryerjen e këtij operacioni KQZ ka shpenzuar mjete të konsiderueshme edhe për thirrjet telefonike ndërkombëtare si dhe materialeve tjera.

Megjithatë, përkundër shtimit të konsiderueshëm të kapaciteteve të KQZ-së për konfirmimin e aplikacioneve, si dhe verifikimin e tyre përmes telefonit, KQZ nuk kishte arritur që brenda afatit të përcaktuar me plan operacional, ta përmbyllë verifikimin. Kjo kishte bërë që 36,414 aplikacione, të cilat nuk ishin verifikuar përmes telefonit, por që kishin plotësuar kushtet paraprake formale, të pranohen në Listën e Votuesve Jashtë Vendit, pas rekomandimit të SKQZ-së. Në këtë drejtim, DnV vlerëson që KQZ duhet që të rishqyrtojë këtë udhëzim, duke nxjerrë mësim, me qëllim të përmirësimit të këtij procesi për zgjedhjet e ardhshme.

Ndërsa, në fillim të procesit, ishte krijuar një aplikacion i dyshimtë 'online', që sipas njoftimit në këtë faqe ishte krijuar për lehtësimin e aplikimit të diasporës. Sidoqoftë, ky aplikacion kishte kërkuar edhe donacione nga qytetarët. I njëjti ishte denoncuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe me këtë çështje janë marrë edhe organet e rendit, por që sipas informacioneve zyrtare nuk ka ende një epilog.

Numri i përgjithshëm i pakove me fletëvotime të supozuara, të cilat kanë ardhur në fahun postar dhe që janë pranuar KQZ-ja është 43,447. Në kuadër të këtyre pakove, pjesa dërrmuese e tyre, përkatësisht 35,375 sosh, janë pranuar në Qendrën Tranzicionale Postare (QTP). Po ashtu, 433 pako janë pranuar në postën numër 6 të KQZ-së. Pjesa e mbetur e pakova janë pranuar përmes postave të shpejta, të tilla si DHL (5,695), TNT (917), UPS (1,057).

Sa i përket pakove të aprovuara sipas shteteve nga ku është aplikuar, sërish prin Gjermania me 26,472 pako të aprovuara, pasuar nga Zvicra me 17,010 pako, Austria me 3,183 pako, Suedia me 1,550 pako, Franca me 1,532

Sipas të dhënave të ofruara nga SKQZ, votimi jashtë vendit del të jetë një prej operacioneve më të kushtueshme zgjedhore të këtij procesi. Vetëm për stafin e angazhuar në këtë proces, duke përfshirë zyrtarët e shërbimit votues, procesuesit e të dhënave dhe thirrësit telefonik, janë shpenzuar mbi 200 mijë euro, prej të cilave rreth 75 mijë ishin për stafin jo-permanent të procesimit të të dhënave dhe thirrësve telefonik, ndërsa mbi 130 mijë euro për zyrtarët e shërbimit votues. Në këtë shumë, nuk janë përlogaritur shpenzimet e thirrjeve telefonike dhe materialeve tjera shpenzuese që janë përdorur nga stafi përkatës.

pako dhe Italia me 1,400 pako. Kurse, lidhur me numrin e pakove të aprovuara sipas komunave të Kosovës, ku votuesit janë të regjistruar, prin Prishtina me 5,524 pako, komuna të përziera me 4,569 pako, Gjilani me 4,059 pako, Ferizaj me 3,883 pako dhe Prizreni me 3,735 pako.

Nga 102,467 votues të regjistruar suksesshëm, pakot me fletëvotime kanë arritur t'i dërgojnë 56,610 votues, apo 55.24 % e votuesve të regjistruar suksesshëm. Shërbimi i votuesve i KQZ-së ka arritur të procedojë dhe vlerësojë 79,201 pako të individualizuara, prej të cilave janë refuzuar 22,591. Prej tyre, shumica dërrmuese janë refuzuar për shkak se personat nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim, apo për shkak se aplikuesit janë refuzuar gjatë periudhës përkatëse. Mbi 1 mijë persona janë refuzuar meqenëse kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se një herë.

Kodi i refuzimit	Arsyet e refuzimit	Numri i të refuzuarve
D1	Personat që nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim	9,199
D2	Personat e refuzuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim	6,665
D4	Personat që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se një herë	1,325
D5	Personat që nuk janë identifikuar (që kanë dërguar vetëm fletëvotim) dhe persona që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se persona të aprovuara	2,451
D6	Personat që nuk kanë dëshmuar identitetin me dokumente valide të identifikimit (që kanë dërguar kopje të dokumenteve me afat të skaduar)	910
D7	Numri i pakove me fletëvotime për këtë kategori janë refuzuar për arsye se pakoja përmban numër të fletëvotimeve jashtë rrethit të ngushtë familjarë <sup>9</sup> .	1,656
D8	Pako me fletëvotime që janë dorëzuar personalisht në postën numër 6 <sup>10</sup> .	385
<b>TOTALI</b>		<b>22,591</b>

**TABELA 2** Arsyet e refuzimit të aplikacioneve të votimit jashtë vendit<sup>11</sup>

Sipas raportimeve zyrtare nga SKQZ, pas afatit ligjor 24 orësh, në fahun postar të KQZ-së kanë ardhur 9,030 pako të supozuara me fletëvotime. Të njëjtat, përkundër kërkesave të anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, nuk ishin përfshirë në rezultate, e madje as nuk kishte pasur fare vendimmarrje. Si rrjedhojë, Lëvizja Vetëvendosje i ishte drejtuar PZAP-së, duke kërkuar që të urdhërohet KQZ t'i numërojë 20,550 pako me fletëvotime të supozuara të ardhura pas afatit, kërkesë kjo e cila ishte refuzuar nga PZAP, dhe ishte refuzuar edhe nga Gjykata Supreme si e pabazuar.

Bazuar në rezultatet e publikuara nga KQZ për votimin jashtë vendit, LVV vazhdon të prijë bindshëm në kuadër të kësaj forme të votimit, me rreth 80% të votave të fituara.

Sipas të dhënave të ofruara nga SKQZ, votimi jashtë vendit del të jetë një prej operacioneve më të kushtueshme zgjedhore të këtij procesi. Vetëm për stafin e angazhuar në këtë proces, duke përfshirë zyrtarët e shërbimit votues, procesuesit e të dhënave dhe thirrësit telefonik, janë shpenzuar mbi 200 mijë euro, prej të cilave rreth 75 mijë ishin për stafin jo-permanent të procesimit të të dhënave dhe thirrësve telefonik, ndërsa mbi 130 mijë euro për zyrtarët e shërbimit votues. Në këtë shumë, nuk janë përllogaritur shpenzimet e thirrjeve telefonike dhe materialeve tjera shpenzuese që janë përdorur nga stafi përkatës.

9 Për kategorinë "D7" janë dërguar 153 pako me fletëvotime që tejkalojnë rrethin e ngushtë familjarë. Numri i pakove të individualizuara me fletëvotime, të refuzuar sipas kësaj kategorie përmban gjithsej 1,656 zarfe të individualizuara me fletëvotime (shembull: brenda një pako me fletëvotime kanë qenë 84 zarfe të individualizuara me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjarë, 39, 37, 35, 33, 30 zarfe të individualizuara me fletëvotime jashtë rrethit të ngushtë familjarë, etj.)

10 Pakot me fletëvotime sipas kategorisë së refuzimit "D8" nuk përmbajnë vullën dhe pullën postare të postës dërguese.

11 Këto të dhëna dhe tabela si e tillë bazohen në Raportin Përfundimtar për Periudhën e Votimit përmes Postës, i datës 1 mars 2021, i përpiluar nga KQZ.

---

## 5. FUSHATA ZGJEDHORE

Për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 14 shkurtit, KQZ-ja përcaktoi afatin kohor prej 10 ditësh për organizimin e fushatës zgjedhore e cila formalisht filloi më 3 shkurt dhe u përmbyll më 12 shkurt 2021. Si në zgjedhjet paraprake, fushata zgjedhore është paraprirë nga një parafushatë intensive, e cila është zhvilluar sidomos nëpër rrjetet sociale dhe mediat tradicionale. Ky fenomen ka karakterizuar edhe këtë proces, kryesisht në mungesë të sanksioneve dhe rregullimeve ligjore.

Situata e rënduar me pandeminë nuk ishte parë si pengesë nga subjektet politike për zhvillimin e një fushate zgjedhore dinamike, përveç në komunat me shumicë serbe ku praktikisht nuk kishte fare fushatë. Megjithatë, pandemia kishte imponuar ndryshime në mënyrën e të bërit fushatë nga subjektet politike, të cilat një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve i kishin fokusuar në mediat tradicionale dhe rrjetet sociale, sidomos në periudhën e parafushatës. Ndonëse në masë të madhe është vërejtur ndryshimin i formatit të organizimeve të subjekteve politike, orientimi i tyre kryesisht në premtime elektorale është parë si vazhdimësi e trendëve të fushatave të mëparshme dhe riciklim i mesazheve paraprake. Ndonëse tubimet publike ishin forma më e preferuar e të bërit fushatë nga subjektet politike, edhe ecjet në sheshe publike ishin formë e re, por mjaft e shprehur e të bërit fushatë. Ndërsa, është vërejtur një tendencë e shtuar e subjekteve politike për të mos paralajmëruar aktivitetet zgjedhore pranë institucioneve përkatëse. Përkundër faktit që në kuadër të vendimit për shkurtimin e afateve për aktivitetet zgjedhore ishte shkurtuar edhe periudha e paralajmërimit të aktiviteteve nga 72 orë në jo më vonë se 24 orë para mbajtjes së tyre, rreth 30% e aktiviteteve zgjedhore nuk janë paralajmëruar në KKZ-të përkatëse, që shënon dukuri negative krahasuar me zgjedhjet paraprake.

Shumica e aktiviteteve të fushatës janë zhvilluar pa përfillje të masave kundër përhapjes së pandemisë, duke rezultuar me numër të shtuar të infeksioneve të reja disa javë pas fushatës. Pavarësisht shqiptimit të disa gjobave dhe ndëshkimeve ndaj subjekteve politike, nga inspektoratet e Komunës së Prishtinës dhe më pak të asaj të Prizrenit, për mosrespektim të masave anti-COVID, të njëjtat nuk ishin treguar mjaftueshëm efektive. Institucionet tjera përgjegjëse të nivelit qendror nuk ndërmorën masa të mjaftueshme për ti parandaluar apo ndëshkuar subjektet politike që nuk i respektuan këto masa. Joefikasiteti i inspektorateve komunale në nivel vendi, inspektorateve të tjera në nivel qendror, si dhe Policisë për të shqiptuar gjoba në përputhje me legjislacionin, ka qenë faktor kontribuues në keqësimin e situatës në këtë drejtim.

Fryma e fushatës është manifestuar kryesisht përmes narracionit të rivaliteteve politike mes eksponentëve të subjekteve politike, e jo domosdoshmërisht përmes platformave të artikuluar politike, të cilat janë publikuar vetëm pak ditë para përmbylljes së fushatës. Madje, janë evidentuar edhe raste të gjuhës së urrejtjes mbi baza partiake dhe gjinore gjatë 10 ditëve të fushatës zgjedhore. Gjuha e urrejtjes ka qenë e pranishme në rreth 23% të aktiviteteve zgjedhore të monitoruara.

Mungesa e kulturës së njëmendtë të konkurrencës politike ka rezultuar me mungesë të debateve dhe përballjeve mes kandidatëve të subjekteve politike, që mund të ketë limituar votuesit në përcaktimin e votës së tyre bazuar në orientime të qarta programore. Gjithsesi, është vërejtur një motivim dhe entuziazëm i shtuar qytetar për të marrë pjesë në aktivitete zgjedhore.

Temat për të cilat subjektet garuese folën më së shumti në fushatë ishin zhvillimi ekonomik, bujqësia dhe punë-

simi, arsimi, sigurimet shëndetësore, pensionet dhe mirëqenia sociale. Vëmendje e veçantë ju kushtua dhe edukimit qytetar në 56% të aktiviteteve zgjedhore ku mbizotëruan ofrimi i informacione rreth mënyrës së votimit, shpërndarja e broshurave dhe kartëvizitave. Ndërsa, nuk u përjashtuan edhe kërkesat për të votuar deputetë nga rajone të caktuara të vendit.

Përgjithësisht, edhe gjatë kësaj fushate, pavarësisht retorikës së shtuar të subjekteve politike për përfaqësim të barabartë gjinor, ato nuk u kanë ofruar grave qasje të barabartë në garën zgjedhore, në kundërshtim me ligjin për barazi gjinore, i cili proklamoi përfaqësimin e barabartë. Si folëse, gratë kanë marrë pjesë në vetëm 27%, ndërsa si pjesëmarrëse vetëm në 22% të aktiviteteve të monitoruara.

Pavarësisht se në Kosovë jetojnë mbi 200,000 persona me aftësi të kufizuara, pjesëmarrja e tyre në aktivitete zgjedhore mbetet tejet e ulët, meqë vetëm 247 persona morën pjesë në aktivitetet e monitoruara zgjedhore në shtatë qendrat kryesore. Mungesa e infrastrukturës së duhur për qasje të personave me aftësi të kufizuara ka vështirësuar dhe më tej pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet zgjedhore, meqenëse në 31% të aktiviteteve nuk është garantuar qasje adekuate për këtë kategori. Në këtë fushatë zgjedhore, në asnjë rast nuk ka pasur persona me aftësi të kufizuar të cilët i janë adresuar elektoratit.

Përdorimi i resurseve publike, financiare apo njerëzore, sidomos nga subjektet politike në pushtet – si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal – ka vijuar që si fenomen të shoqërojë aktivitetet e fushatës së subjekteve politike, ndonëse jo në përmasa sikur gjatë zgjedhjeve paraprake. Ky fenomen është evidentuar në gjithsej 38 aktivitete, në të cilat është evidentuar përdorimi i veturave zyrtare në 9 aktivitete zgjedhore dhe në 19 aktivitete zgjedhore pjesëmarrje të shërbyesve publik. Mediat kanë qenë të pranishme në 42% të aktiviteteve zgjedhore.

## 5.1 Shpenzimet e Subjekteve Politike

Në bazë të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, KQZ-ja është institucioni i cili përcakton shumën maksimale që mund të shpenzohet nga subjektet politike për organizimin e aktiviteteve zgjedhore. Në bazë të ligjit, KQZ-ja

përcakton këtë kulm të shpenzimeve duke u mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të saj. Duke u nisur nga kjo, më 11 janar, pas marrjes së ekstraktit përkatës, KQZ-ja përcaktoi që shuma më e lartë që subjektet politike mund të shpenzojnë për aktivitete zgjedhore të jetë 934,831 euro, bazuar në formulën si në vijim:

*[0.50 euro x Numri i Votuesve të Regjistruar = Shuma Maksimale për Shpenzim]*

Demokracia në Veprim para fillimit zyrtar të fushatës kanë realizuar hulumtimin lidhur me shpenzimet e subjekteve politike për fushatën elektorale në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2021.

Transparenca dhe llogaridhënia e subjekteve politike në financimin dhe shpenzimet e tyre janë një shembull i mirë për votuesin dhe demokracinë e një vendi. E drejta për të ditur se nga financohen subjektet politike që garojnë për qeverisje të vendit dhe se si i shpenzojnë ato parat është një e drejtë e cila parashihet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për financimin e partive politike. Mirëpo kjo e drejtë është standard ndërkombëtare i transparencës dhe llogaridhënies për subjekte politike.

Në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës kanë garuar 28 subjekte politike, DnV ka arritur të gjejë kontaktet për 25 subjekte politike garues. Ndërsa në ueb faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku janë të vendosura emrat e të gjitha subjekteve politike të certifikuara, DnV nuk ka arritur të gjej informata dhe të dhëna për të kontaktuar me këto tri subjekte.

Tutje 7 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore, DnV ka dërguar një pyetësor me 24 pyetje tek 25 subjekte politike kontaktet e të cilave kanë qenë publike në ueb faqen e KQZ-së.

Vetëm 3 nga 25 subjektet politike të cilave iu është dërguar pyetësori janë përgjigjur. Nga data e dërgimit subjektet politike kanë pasur 7 ditë kohë që të përgjigjen në pyetësorin e dërguar. Pyetësori është dërguar me datën 28 janar ndërsa përgjigjet janë pritur deri më 4 shkurt 2021.

---

Subjektet politike që i janë përgjigjur pyetësorit janë: KDTP (Kosova Demokratik Türk Partisi), Partia Fjala dhe Lëvizja Vetëvendosje.

Dy subjektet e para janë subjekte të vogla politike dhe i janë përgjigjur pyetësorit pjesërisht kjo pasi që edhe buxheti i tyre për fushatë ka qenë shumë i vogël dhe destinimi i shpenzimeve të tyre e ka qenë në marketing për subjektin dhe kandidatët për deputet.

Në anën tjetër Lëvizja Vetëvendosje, si subjekti më i madh politik në vend, ka deklaruar se do të shpenzoj mbi gjysmë milioni euro (571,684.19 euro) në fushatën zgjedhore. Shpenzimet më të mëdha sipas përgjigjeve të tyre kanë qenë në marketing, televizione dhe media, media sociale, por edhe shpenzime të tjera operative si pagesa për aktivistë e anëtar të subjektit politik, shpenzime për zyra dhe telefon etj.

Subjektet të tjera parlamentare, deri në zgjedhjet e fundit, si Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NIS-MA dhe Srpska Lista nuk i janë përgjigjur pyetësorit, edhe pse të njëjtat kanë pas të hyra nga fondi i buxhetit të shtetit për demokratizim.

Transparenca për subjektet politike është një rrugë e gjatë që duhet ta ndjekin të gjitha subjektet politike. Fakti që disa subjekte politike publikojnë të hyrat dhe shpenzimet e tyre është hap që duhet ndjekur nga të gjitha subjektet politike në vend.

Demokracia në Veprim, do të vazhdojë monitorimin e deklarimeve financiare dhe shpenzimeve për fushatë zgjedhore të subjekteve politike tek KQZ, e që më pas të mund të bëjë krahasimin me deklaratimet në pyetësor.

Transparenca dhe llogaridhënia e subjekteve politike në financimin dhe shpenzimet e tyre janë një shembull i mirë për votuesin dhe demokracinë e një vendi. E drejta për të ditur se nga financohen subjektet politike që garojnë për qeverisje të vendit dhe se si i shpenzojnë ato parat është një e drejtë e cila parashihet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për financimin e partive politike. Mirëpo kjo e drejtë është standard ndërkombëtare i transparencës dhe llogaridhënies për subjekte politike.

---

## 6. PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCES ZGJEDHOR

Përfshirja e grave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit mund të vlerësohet nga disa perspektiva, përfshirë përfshirjen në lista zgjedhore, trupa menaxhuese të zgjedhjeve, fushatë, mbulueshmëri në media dhe rezultat zgjedhor, mbi të cilat vlerësimet janë të ndryshme.

Së pari, sa i përket përfshirjes së grave në listat zgjedhore, përfaqësimi jo i barabartë i grave dhe burrave në lista e kandidatëve për deputetë të subjekteve politike, ka treguar që grave nuk i ofrohet hapësira e barabartë në listat zgjedhore, duke rënë në kundërshtim me Ligjin për Barazi Gjinore dhe parimeve bazë të demokracisë, bazuar në të cilat do të duhej të aplikoheshin kuota gjinore 50% në listat zgjedhore. Edhe në këto zgjedhje, pothuajse të gjitha subjektet politike kanë respektuar vetëm kriterin minimal të përfshirjes së gjinisë më pak të përfaqësuar, prej 30%.

Përfshirja e grave në listat zgjedhore të parakohshme të 14 shkurtit është bërë në mënyrë të përfshirë në listat zgjedhore të 28 subjekteve politike të certifikuara politike, kishin aplikuar për regjistrim fillimisht gjithsej 1,081 kandidatë. Prej tyre, 719, përkatësisht 66.5% ishin burra, ndërsa 362, përkatësisht 33.5% ishin gra. Pas vendimeve të instancave gjyqësore dhe kërkesave të subjekteve politike për tërheqjen e disa kandidatëve, numri i kandidatëve të certifikuar kishte rënë në gjithsej 1,052, prej të cilëve 359, apo 34.1%, ishin gra.

	<b>Burra</b>	<b>Gra</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Përqindja</b>
<b>AAK</b>	74	33	107	31%
<b>FJALA</b>	17	8	25	32%
<b>GI-SPO</b>	2	1	3	33%
<b>IRDK</b>	25	13	38	34%
<b>JGP</b>	11	5	16	31%
<b>KDTP</b>	17	9	26	35%
<b>KNRP</b>	3	2	5	40%
<b>LDK</b>	77	33	110	30%
<b>LpB</b>	24	11	35	31%
<b>LPRK</b>	6	4	10	40%
<b>LS</b>	13	7	20	35%
<b>LVV</b>	67	40	107	37%
<b>NAŠA</b>	15	7	22	32%
<b>NDS</b>	23	19	42	45%
<b>NISMA</b>	67	31	98	32%
<b>PAI</b>	25	13	38	34%
<b>PB</b>	3	2	5	40%
<b>PDAK</b>	28	15	43	35%
<b>PDK</b>	77	33	110	30%
<b>PLE</b>	25	15	40	38%
<b>PREBK</b>	20	12	32	38%
<b>RI</b>	7	5	12	42%
<b>SDS</b>	3	2	5	40%
<b>SDU</b>	17	8	25	32%
<b>UZ-AH</b>	7	6	13	46%
<b>VAKAT</b>	21	16	37	43%
<b>YTHP</b>	8	4	12	33%
<b>ZAJENO</b>	11	5	16	31%
<b>Gjithsej</b>	693	359	1052	34%

**TABELA 3** Përbërja gjinore e listave të certifikuara të subjekteve politike

Sa i përket trupave menaxhuese të zgjedhjeve, edhe në këtë drejtim, gratë vijojnë të mbesin të nënpërfaqësuar ndjeshëm. Në radhët e këtyre trupave, ku përfshihet KQZ, KKZ-të, KVV-të, ekipet mobile e të tjera, gratë në shumë raste nuk janë të përfshira as me kriterin minimal prej 30%. Në kuadër të anëtarëve të KQZ-së, vetëm dy nga gjithsej 11 anëtarë, përfshirë edhe Kryetaren e KQZ-së, janë gra.

Trend i ngjashëm i mospërfshirjes vërehet edhe tek përbërja gjinore e Komisioneve Komunale Zgjedhore, ku, përkundër thirrjeve të vazhdueshme nga DnV-ja që subjektet politike të nominojnë më shumë gra në këto komisione, sërish nga gjithsej 261 anëtarë, vetëm 48 prej tyre ishin gra, apo 18%. Lidhur me këtë, nuk është respektuar as përcaktimi ligjor nga LZP, i cili kërkon nga Sekretariati i KQZ-së që gjatë emërimit të KKZ-ve, t'i kushtojë kujdes të veçantë përfaqësimit të drejtë gjinor. Parë nga përbërja e secilës komunë, vërehet që vetëm një numër i vogël i KKZ-ve kanë pasur edhe përfaqësim minimal prej 30% të grave. Zubin Potoku është komuna e vetme ku në përbërje të KKZ-së ka më shumë gra se burra, në raportin 25-75. Ndërsa, Komuna e Leposaviqit është e vetmja që ka përbërje të barabartë gjinore 50-50% në kuadër të KKZ-së atje. Sipas përqindjeve të përfaqësimit të grave, pasojnë KKZ-të e komunave Mitrovicë e Veriut (44%), Gjilani (43%), Drenasi (40%), Fushë Kosova (38%) dhe Novobërda (38%).

Në anën tjetër, janë plot 13 komuna, KKZ-të e së cilave nuk kanë asnjë grua në përbërjet e tyre. Komunitat në fjalë janë Deçani, Dragashi, Klina, Kamenica, Obiliqi, Podujeva, Prishtina, Ferizaj, Vitia, Vushtrria, Malisheva, Graçanica dhe Ranilluga. Kjo flet për një tendencë dhe qasje shpërfillëse ndaj grave nga ana e subjekteve politike, veçanërisht në komunat e mëdha dhe zonat urbane, duke mos i përfshirë të njëjtat në trupat menaxhuese të zgjedhjeve.

Prania e ulët e grave vërehet edhe tek Këshillat e Vendvotimeve, si trupa që kanë përgjegjësi për administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve. Përkundër dakordimit në mes të subjekteve politike për përfaqësim të grave në administrim të zgjedhjeve në nivelin prej të paktën 40%<sup>12</sup>, edhe në këto zgjedhje,

sipas raportimeve të vëzhguesve të DnV-së, vetëm 31% e Këshillave të Vendvotimeve në nivel vendi kanë qenë të përbëra nga gratë.

Ndërsa, sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së, nga gjithsej 16,525 persona të angazhuar si staf i KVV-ve në nivel vendi, vetëm 5,119 ishin gra. Në kuadër të tyre, vërehet një trend më i madh i përfshirjes së grave në komunën e Mitrovicës së Veriut (48%), Prishtinës (45%), Ranillugut (41%), Mitrovicës së Jugut (38%) dhe Ferizajt (37%). Kurse, pjesëmarrje në nivele shumë të ulëta vërehet në komunën e Mamushës (2% – apo vetëm një komisione grua), Dragashit (7%) dhe Shtërpçës (14%).

Në anën tjetër, sa i përket përbërjes së stafit teknik të Qendrave të Votimit, është më se e evidente një trend tejet negativ i përfshirjes së grave. Nga mbi 6 mijë persona të angazhuar si staf, vetëm 856, përkatësisht 14% janë gra.

Ndër trupat përgjegjëse për menaxhimin dhe organizimin e zgjedhjeve, përfshirja e grave është në nivel të kënaqshëm vetëm tek trajnerët e angazhuar nga KKZ-të e secilës komunë. Nga gjithsej 274 persona, më shumë se gjysma e tyre, gjegjësisht 54% janë gra.

Krahas mospërfshirjes së barabartë në lista zgjedhore, trupa menaxhuese të zgjedhjeve e të ngjashme, pavarësisht retorikës së shtuar të subjekteve politike për përfaqësim dhe përfshirje të barabartë gjinore, ato nuk u kanë ofruar grave qasje të barabartë as në garën zgjedhore, respektivisht në fushatën zgjedhore. Sipas të dhënave të vëzhguesve të DnV-së, gratë, si folëse, kanë marrë pjesë në vetëm 27%, ndërsa si pjesëmarrëse vetëm në 22% të aktiviteteve të monitoruara. Edhe pse është shënuar një rritje e vogël e pjesëmarrjes së grave në tubime krahasuar me zgjedhjet e kaluara, pjesëmarrja e grave si folëse në tubime publike mbetet një ndër sfidat kryesore me të cilën ballafaqohen kandidatet gra. Për më tepër, kjo tregon që kandidatet gra nuk gëzojnë të drejtë të barabartë me kandidatët burra brenda subjekteve politike për ti shpalosur idetë e tyre përball elektoratit.

Edhe pjesëmarrja e grave në tubimet publike, në spote të organizuara nga subjektet politike si dhe pjesëmarrja e tyre në debate televizive ka qenë tejet e kufizuar. Pjesëmarrja e grave në spotet të organizuara nga subjektet politike ka qenë vetëm 16%, kurse të dhënat

12 Nënshkrimi i Deklaratës për rritjen e përfshirjes së grave në proceset zgjedhore. D4D. Qasur në: <https://d4d-ks.org/aktivitetet/nenshkrimi-i-deklarates-per-rritjen-e-perfshirjes-se-grave-ne-proceset-zgjedhore/>



---

tregojnë që pjesëmarrja e grave në debate televizive edhe në këtë fushatë zgjedhore ka qenë vetëm 22%. Mungesa e vullnetit të subjekteve politike për të mbështetur kandidatet gra në fushatë zgjedhore, ka rezultuar me gara zgjedhore diskriminuese jo e favorshme për gratë.

Megjithatë, përkundër mospërfshirjes në pothuajse të gjitha fazat e procesit zgjedhor, në këto zgjedhje bie në sy një zhvillim tejet pozitiv – me një rritje të konsiderueshme të grave që kanë arritur të fitojnë mandate pa ndihmën e kuotës që aplikohet gjatë ndarjes së ulëseve në Kuvend. Bazuar në rezultatet e certifikuara nga ana e KQZ-së, nga gjithsej 120 deputetë të Kuvendit, 43 prej tyre, apo rreth 36% të jenë gra. Në kuadër të këtyre ulëseve të fituara nga gratë, vetëm 20% janë fituar në saje të kuotës, me respektivisht 34 ulëse të fituara pa ndihmën e kuotës, si dhe vetëm 9 deputete që janë zgjedhur me kuotë.

Sipas numrit të mandateve të fituara, LVV është subjekti i vetëm ku të gjitha kandidatet 23 kandidatet e zgjedhur, kanë fituar ulëse pa ndihmën e kuotës. Në radhët e PDK-së, tri kandidate janë zgjedhur pa kuotë, e tri të tjera me kuotë, pasuar nga LDK, ku vetëm një kandidate është zgjedhur pa kuotë, e katër të tjera me kuotë, AAK ku një kandidate është zgjedhur pa kuotë, si dhe dy të tjera me kuotë. Nga radhët e komuniteteve, pa ndihmën e kuotës janë zgjedhur tri kandidatet e LS, si dhe një tjetër nga KDTP. Ndërsa, në radhët e SDU dhe NDS, mandat kanë fituar bartëset e listave të këtyre subjekteve, që janë gra.

Madje, vlen të përmendet që në këto zgjedhje, personi më i votuar është pikërisht një grua, Vjosa Osmani, e cila ka fituar mbi 300 mijë vota, duke u bërë kandidatja më e votuar në historinë zgjedhore të Kosovës. Ndërsa, në mesin e 10 kandidatëve më të votuar të këtyre zgjedhjeve, 4 prej tyre janë gra.

Sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së, nga gjithsej 16,525 persona të angazhuar si staf i KVV-ve në nivel vendi, vetëm 5,119 ishin gra. Në kuadër të tyre, vërehet një trend më i madh i përfshirjes së grave në komunën e Mitrovicës së Veriut (48%), Prishtinës (45%), Ranillugut (41%), Mitrovicës së Jugut (38%) dhe Ferizajt (37%). Kurse, pjesëmarrje në nivele shumë të ulëta vërehet në komunën e Mamushës (2% – apo vetëm një komisionere grua), Dragashit (7%) dhe Shtërpçës (14%).

Në anën tjetër, sa i përket përbërjes së stafit teknik të Qendrave të Votimit, është më se evidente një trend tejet negativ i përfshirjes së grave. Nga mbi 6 mijë persona të angazhuar si staf, vetëm 856, përkatësisht 14% janë gra.

---

## 7. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Përkundër situatës me pandeminë, edhe këto zgjedhje kanë qenë të mbuluara dhe të vëzhguara nga një numër i madh i organizatave dhe subjekteve politike, ndonëse me një rënie të lehtë krahasuar me zgjedhjet e fundit. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ka rekomanduar akreditimin e gjithsej 29,200 vëzhguesve, nga rreth 140 organizata vëzhguesve. Shumica dërrmuese e vëzhguesve kanë qenë vëzhgues të subjekteve politike.

Ndërsa, në kuadër të organizatave joqeveritare vendore, DnV, përkatësisht organizatat partnere kanë angazhuar gati gjysmën e numrit të përgjithshëm të vëzhguesve, me mbi 800 vëzhgues të akredituar gjithsej. Për vëzhgimin e zgjedhjeve janë akredituar vëzhgues nga 18 ambasada, gjashtë organizata ndërkombëtare, një institucion publik (Avokati i Popullit), 26 organizata vendore, 23 subjekte politike, si dhe rreth 63 medime vendore dhe ndërkombëtare.

Në këto zgjedhje nuk është raportuar për ndonjë organizatë 'fantome' e cila është regjistruar për vëzhgimin e zgjedhjeve, siç kemi pasur raste në proceset zgjedhore paraprake.

Këto zgjedhje nuk janë vëzhguar, si rëndom, nga EU-EOM – Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Sidoqoftë, duke ndjekur një qasje të njohur si "*diplowatch*", grupe të kufizuara të ekspertëve nga BE, por edhe nga Britania e Madhe, kanë marrë pjesë në monitorimin e procesit zgjedhor në përgjithësi. Të njëjtit kanë zhvilluar takime me aktorë relevantë të procesit zgjedhor, përfshirë trupat menaxhuese të zgjedhjeve, subjekteve politike garuese, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

---

## 8. DITA E ZGJEDHJEVE

Demokracia në Veprim, përmes 500 vëzhguesve statik si dhe mbi 100 vëzhguesve tjerë që kanë shërbyer si ekupe mobile, ka vëzhguar përmes metodologjisë PVT, 500 vendvotime të shpërndara në nivel vendi, duke përfshirë secilën komunë.

Dita e zgjedhjeve është zhvilluar e qetë dhe pa ndonjë incident serioz që do të mund të ndikonte në integritetin apo kredibilitetin e procesit zgjedhor. Prosesi i votimit ishte i rregullt, mirëpo i njëjti është karakterizuar nga disa parregullsi të përsëritura nga ciklet e mëparshme zgjedhore, si shkalla e lartë e votimit me asistencë, rastet e shtuara të votimit me asistencë të parregullt dhe vështirësitë e votuesve për të gjetur vendvotimet të tyre.

Sipas raportimeve të vëzhguesve të DnV-së, pothuajse të gjitha vendvotimet janë hapur me kohë. Në vetëm 3% të vendvotimeve janë shënuar vonesa në hapje, kryesisht për shkak të mungesës së materialeve zgjedhore – të tilla si zarfet e fletëvotimeve me kusht në vendvotimet e dyfishta (6.1%), vulat (2.4%), Lista e Votuesve (2.4%), UV llamba (2.6%) dhe Spreji (2.4%) – por edhe për shkak të vonesave të komisionerëve si rezultat i motit të keq.

Ndonëse prezenca e materialeve propaganduese të subjekteve politike në afërsi të Qendrave të Votimit në ditën e zgjedhjeve, brenda perimetrit prej 100 metrave, ende kjo parregullsi nuk është eliminuar tërësisht. Në këto zgjedhje është raportuar për prani të këtyre materialeve vetëm në 1.2% të rasteve, që përbën përmirësim të ndjeshëm në krahasim me zgjedhjet paraprake, kur kjo përqindje ishte mbi 7%.

Në anën tjetër, përkundër përcaktimeve ligjore, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se në çerekun e vend-

votimeve, përkatësisht rreth 19% sosh, nuk ka pasur zyrtarë policor në hyrje të Qendrave të Votimit gjatë tërë kohës.

Me qëllim të garantimit të respektimit të masave parandaluese kundër COVID19, që janë rekomanduar nga institucionet shëndetësore, KQZ ka dizajnuar posterë që përmbajnë udhëzime të detajuara dhe të qarta, të cilave qytetarët duhet t'u përmbahen gjatë procesit të votimit në mënyrë që t'a ruajnë shëndetin e tyre (vendosja e maskës, mbajtja e distancës dhe dezinfektimi i duarve). KQZ po ashtu ka zhvilluar edhe kampanja për informim të qytetarëve lidhur me votimin në kushte pandemie. Sidoqoftë, DnV ka evidentuar që këta posterë nuk janë vendosur në 5% të Qendrave të Votimit. Po ashtu, është evidentuar se në 97% të vendvotimeve ka pasur pajisje mbrojtëse. Sidoqoftë, në mesin e këtyre pajisjeve, përveç maskave dhe dezinfektuesve të cilat u janë dhënë komisionerëve në rreth 95% të vendvotimeve, dorezat nuk kanë qenë të pranishme në rreth 40% të vendvotimeve në nivel vendi, duke rënë ndesh kështu me udhëzimin përkatës të KQZ-së për parandalimin e shpërndarjes së pandemisë.

Një numër i konsiderueshëm i Qendrave të Votimit në Kosovë vazhdojnë të jenë të pa qasshme për personat me aftësi të kufizuar fizike, duke cenuar parimin e barazisë së mundësisë për të votuar. Është raportuar se në 30% e Qendrave të Votimit në nivel vendi nuk është ofruar infrastrukturë adekuate për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

Prania e grave komisionere vazhdon të jetë e ulët edhe në këto zgjedhje, pavarësisht garancive ligjore dhe kërkesave të vazhdueshme të shoqërisë civile për pjesëmarrje të barabartë. Pjesëmarrja e grave në cilësinë e komisionereve në vendvotime është 31%,

më e ulët se në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2019, kur gratë komisionerë përbënin rreth 35% të numrit të përgjithshëm të vendvotimeve. Ndërsa në zgjedhjet e fundit lokale të 2017-tës, ishte 29 %.

Pothuajse në të gjitha vendvotimet në nivel vendi (99.4%), kabinat e votimit është raportuar se kanë qenë të vendosura në atë mënyrë që të garantojnë fshehtësinë e votës së qytetarëve. Ndërsa në 4.6% të vendvotimeve është raportuar për mungesë të broshurave të kandidatëve të subjekteve politike në kabinat e votimit.

Procesi i votimit në përgjithësi ka rrjedhur normalisht dhe në frymë të qetë, duke u mos u evidentuar asnjë rast i mbylljes së vendvotimeve si rezultat i ndonjë incidenti serioz.

Procesi i votimit në përgjithësi u zhvillua me zbatim adekuat të masave kundër COVID-19 në 70% të vendvotimeve. Ndonëse gjatë gjithë ditës u bënë thirrje të vazhdueshme për respektim të tyre, në rreth 30% të vendvotimeve ka pasur zbatim të pjesshëm të këtyre masave. Në anën tjetër, përkundër obligimit që votuesit të heqin maskën me qëllim të identifikimit, siç është përcaktuar me Udhëzimin e KQZ-së, komisionerët kanë kërkuar nga votuesit që të respektojnë këtë masë në vetëm 32% të vendvotimeve. Kurse, në pjesën tjetër të vendvotimeve ka pasur respektim të pjesshëm (43%) apo nuk ka pasur fare respektim të këtij përcaktimi (25%).

Votimi me asistencë, që është kategori e lejuar nën kushtet e caktuara për situata specifike, siç parashihet edhe në dispozitat përkatëse, ka vazhduar të jetë qenë dukuri shumë e shprehur dhe e përhapur njëtrajtshëm në gjithë vendin. Votimi me asistencë të regjistruar është raportuar në 98% të vendvotimeve, me kryesisht deri në 50 raste të raportuara në secilin vendvotim – 24% prej të cilave 1 deri në 10 raste, 72% në 11 deri 50 raste, si dhe 2% mbi 50 raste për vendvotim. Në 19% të vendvotimeve ka pasur raste të votimit me asistencë e cila nuk është regjistruar sipas rregullave të përcaktuara. Ky fenomen është i shprehur në 1-10 raste në 16% të vendvotimeve, si dhe 11 deri në 50 raste në 3% të vendvotimeve. Në 7% të vendvotimeve është raportuar për raste kur i njëjti person ka asistuar më shumë se një herë, e shprehur në raste të izoluar, me 1 deri në 4 raste të evidentuara.

Zvogëlimi i numrit të përgjithshëm të vendvotimeve në këto zgjedhje nga 2,547, sa ishin në 2019, në 2,382, ka prodhuar vështirësi tek qytetarët për t'a gjetur emrin në Listën e Votuesve, rrjedhimisht vendvotimin e duhur. Deri në përmbyllje të procesit të votimit, në 68% të vendvotimeve është raportuar për vështirësi në gjetjen e emrit në Listën e Votuesve. Prej tyre, në 46% të vendvotimeve janë raportuar 1 deri në 10 raste të tilla, 20% të vendvotimeve nga 11 deri në 50 raste, si dhe në rreth 2% mbi 50 raste të tilla.

Në kuadër të parregullsive që ndërlidhen me cenimin e fshehtësisë së votës, ndonëse vepër penale, fotografimi i votës është evidentuar në 6.6% të vendvotimeve, me 1 deri në 4 raste të raportuara në to.

Procesi i votimit është përmbyllur në kohë dhe pa ndonjë incident serioz në këtë periudhë. Nga vëzhguesit nuk është raportuar ndonjë rast kur votuesit që kanë qenë në radhë duke pritur për të votuar para orës 19:00 nuk janë lejuar të votojnë. Përgjithësisht i rregullt ka qenë edhe procesi i numërimit, mirëpo janë shënuar incidente të vogla, të cilat janë trajtuar nga Policia e Kosovës (PK).

Procesi i votimit është përmbyllur në kohë në pothuajse të gjitha vendvotimet, me përjashtim të 4% të vendvotimeve të cilat janë mbyllur para kohe, si dhe rreth 2% të vendvotimeve që janë mbyllur me mbi 15 minuta vonesë. Në rreth 20% të vendvotimeve ka pasur votues të cilët kanë qenë duke pritur në radhë për të votuar, prej të cilëve votuesit janë lejuar të votojnë në 17% të vendvotimeve. Gjithsesi, në 2% të vendvotimeve, qytetarët nuk u lejuan të votojnë pavarësisht faktit që ishin duke pritur në radhë para orës 19:00.

Sa i përket daljes së votuesve, përkundër kushteve të vështira atmosferike e radhëve të qytetarëve në Qendra të Votimit, është shënuar trend i lartë i daljes në zgjedhjeve, veçanërisht në zonat e banuara me shumicë serbe ku dalja ka qenë dukshëm e lartë se mesatarja në nivel vendi. Sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së, dalja e votuesve ka qenë 48,78%, që paraqet nivelin më të lartë të daljes së votuesve në zgjedhje parlamentare, që nga shpallja e pavarësisë e tutje.. Ndërsa, sipas të dhënave të raportuara nga vëzhguesit e DnV-së, dalja në pjesën e parë të ditës, përkatësisht deri në ora 10:00, ka qenë 5,2%. Në ora 13:00 dalja ishte 19,8%, ndërsa në ora 16:00 ishte 37,3%.

---

## 9. REZULTATET ZGJEDHORE

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i janë dashur plot 27 ditë për të certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të 14 shkurtit. Fillimisht, pas publikimit të rezultateve preliminare në ditën e zgjedhjeve, proces për të cilin janë angazhuar 920 persona, ishin ngritur dilema lidhur me votat e fituara nga disa subjekte politike nga radhët e komuniteteve, në veçanti boshnjak dhe atij rom. Po ashtu, pikëpyetje të shumta lidhur me saktësinë e rezultateve ishin proklamuar edhe një numër i konsiderueshëm i kandidatëve të subjekteve politike, të cilët kishin deklaruar se ka pasur manipulim të votave të tyre nga radhët e komisionerëve apo stafit të QNR-së.

Subjektet politike Ujedinjena Zajednica – Adrijana Hodžić dhe Romani Inicijativa, ndonëse të regjistruara, përkatësisht certifikuar, rishtazi para procesit zgjedhor, kishin arritur të fitonin numër të pazakontë të votave, të cilat ishin në shpërputhje gati të plotë me shtrirjen demografike të komuniteteve përkatëse në komunat ku ato kishin fituar votat. Këto subjekte, shumicën dërrmuese të votave, i kishin fituar në komunat me shumicë serbe, ku në fakt ka pak koncentrim të komuniteteve në fjalë. Madje, këto subjekte kishin arritur të fitonin vota edhe në komunat ku nuk është i regjistruar zyrtarisht asnjë banor i komuniteteve përkatëse. Në këtë drejtim, edhe dalja e pazakontë në këto komuna, e cila arrin deri në 85%, që është dyfish më e lartë se mesatarja në nivel vendi, kishte hedhur hije të mëdha të dyshimit mbi mundësinë e orkestrimit të votave të komunitetit serb.

Pas shpalljes së rezultateve, subjektet tjera të komuniteteve jo-shumicë, kishin parashtruar ankesë pranë PZAP-së, duke kërkuar anulimin e votave të tyre. Vendimet përkatëse të PZAP-së kishin anuluar një numër të konsiderueshëm të votave të këtyre subjekteve në komunat me shumicë serbe. Subjektet ishin ankuar edhe në Gjykatën Supreme, me dy subjektet në fjalë që

kishin kërkuar rikthimin e këtyre votave dhe subjektet tjera që kishin kërkuar anulimin e tërësishëm të votave. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk kishte aprovuar asnjërën ankesë, duke lënë në fuqi vendimet e PZAP-it. Këto vendime kishin bërë që subjekti politik Ujedinjena Zajednica – Adrijana Hodžić të mos jetë pjesë e Kuvendit, siç parashihej me rezultate përfundimtare, por në vend të tyre një ulëse e kishte fituar subjekti politik Socialdemokratska Unija. Ndërsa, Romani Inicijativa kishte humbur një nga dy mandatet e parapara si të fituara paraprakisht.

Gjithashtu, rinumërimi i një pjese të vendvotimeve me vendim të KQZ-së, kishte prodhuar ndryshime domethënëse edhe në mesin e votat e dy subjekteve politike nga komuniteti ashkali, duke ndryshuar edhe renditjen e subjekteve PDAK dhe PAI, me këtë të fundit që kishte arritur të siguronte votat e nevojshme që të rifitonte një ulëse, në radhët e ulëseve të rezervuara për komunitetin ashkali.

Në anën tjetër, rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ më 4 mars dhe ato të certifikuara më 13 mars, kishin prodhuar ndryshime edhe në listën e kandidatëve të cilët kishin arritur të fitonin mandatin e deputetit, në radhët e listës së AAK-së. Si rezultat i manipulimeve nga disa persona brenda QNR-së, ndaj të cilëve kanë filluar procedurat hetimore penale dhe ndodhen në paraburgim, kandidates Meliza Haradinaj-Stublla i ishin shtuar dhjetëra vota nga disa dengje të fletëvotimeve në kuadër të votave me kusht dhe atyre me postë, duke bërë që e njëjta të kalojë me vota kandidaten Albana Bytyqi. Sidoqoftë, pas rinumërimeve këto manipulimeve ishin adresuar dhe ishte rikthyer gjendja reale me votat e kandidatëve.

---

Bazuar në të dhënat e ofruara nga Sekretariati i KQZ-së, gjatë rinumërimeve është vërejtur që në shumë raste, Fletat që shërbejnë për regjistrim të votave të kandidatëve (të njohura si FLLK), kanë pasur të dhënat më të sakta lidhur me votat e kandidatëve, deri sa janë evidentuar raste të transferimit, përkatësisht tabulimit të gabuar të tyre në formularët zyrtarë të votave të kandidatëve. Sidoqoftë, duke qenë se proceduralisht këto fleta nuk futen në zarfet të cilët hapen tutje në QNR (që përmbajnë Listën Përfundimtare të Votuesve, formularët zyrtarë dhe librin e votimit), të njëjtat nuk mund të merren për bazë pa vendim të KQZ-së për hapjen e kutive.

Sa i përket fletëvotimeve të pavlefshme, në bazë të rezultateve të certifikuara nga KQZ-ja, vërehet një situatë përgjithësisht e ngjashme. Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme është mbi 32 mijë, apo 3.6%, prej të cilave mbi 5 mijë janë të zbrazëta. Pjesa më e madhe e votave të pavlefshme dhe atyre të zbrazëta janë evidentuar në kuadër të votave të rregullta në vend, derisa përqindja e votave të pavlefshme tek votat me kusht dhe votat me postë është dukshëm më e ulët se mesatarja në nivel vendi.

Rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ më 4 mars dhe ato të certifikuara më 13 mars, kishin prodhuar ndryshime edhe në listën e kandidatëve të cilët kishin arritur të fitonin mandatin e deputetit, në radhët e listës së AAK-së. Si rezultat i manipulimeve nga disa persona brenda QNR-së, ndaj të cilëve kanë filluar procedurat hetimore penale dhe ndodhen në paraburgim, kandidates Meliza Haradinaj-Stublla i ishin shtuar dhjetëra vota nga disa dengje të fletëvotimeve në kuadër të votave me kusht dhe atyre me postë, duke bërë që e njëjta të kalojë me vota kandidaten Albana Bytyqi. Sidoqoftë, pas rinumërimeve këto manipulimeve ishin adresuar dhe ishte rikthyer gjendja reale me votat e kandidatëve.

---

## 10. DREJTËSIA ZGJEDHORE

Subjektet politike që marrin pjesë në zgjedhjeve, sipas dispozitave, janë të obliguara ti përmbahen një sërë rregullash të paracaktuara gjatë tërë procesit, e në veçanti gjatë fushatës zgjedhore<sup>13</sup>. Ligji mundëson raportimin e rasteve të shkeljes së rregullave dhe kodit të mirësjelljes nga subjektet politike tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. PZAP është institucion i pavarur dhe i përhershëm, përgjegjës për të vendosur për ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Kryetari i Gjykatës Supreme emëron pesë anëtarët e PZAP-së nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe gjykatave të qarkut.

Sipas ligjit, të drejtën e paraqitjes së ankesës në PZAP ka çdo person i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, apo i është shkelur e drejta e tij/saj gjatë procesit zgjedhor, ose është bërë shkelje e rregullave të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, përmes ligjit rregullohen edhe afatet kohore të paraqitjes së ankesave dhe të shqyrtimit të tyre.

Përgjithësisht, puna e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e kontesteve zgjedhore ka qenë transparente dhe profesionale, sidomos nga ana e PZAP-së e cila në vazhdimësi ka publikuar njoftime dhe të gjitha vendimet e marra lidhur me çështjet e trajtuara.

Për zgjedhjet e 14 shkurtit, PZAP-ja ka trajtuar gjithsej 775 lëndë, prej të cilave 583 ishin apele, 189 ankesa, dy rishikime të vendimeve dhe një kërkesë për tërheqje. Sa i përket vendimeve të KQZ-së, PZAP ka trajtuar 578 apele dhe 21 ankesa. Nga gjithsej 775 lëndët e trajtuara, PZAP ka pranuar 309 prej tyre dhe ka pranuar

pjesërisht 20 të tjera. 315 lëndë të tjera janë refuzuar, 64 janë hedhur si të palejuara, 51 janë hedhur si të pasafatshme, nëntë janë hedhur si të parregullta, pesë janë hedhur si të palejuara dhe të gjykuara, një është hedhur e palejuar si kërkesë për tërheqjen e apelit, si dhe një tjetër ishte kërkesë për tërheqje.

Sipas fazave të procesit zgjedhor, PZAP ka shqyrtuar 376 lëndë për periudhën e parafushatës zgjedhore, ndër të cilat 370 ishin apele, ndërsa gjashtë të tjera ishin ankesa. Përgjatë fushatës zyrtare, PZAP ka shqyrtuar 35 ankesa dhe dy apele, pasuar nga periudha e heshtjes zgjedhore me 102 ankesa dhe dy kërkesa tjera. Për çështje të ndërlidhura me ditën e votimit, PZAP ka shqyrtuar 43 ankesa. Një numër të konsiderueshme të lëndëve, përkatësisht 214 sosh, PZAP i ka shqyrtuar lidhur me rezultatet preliminare të shpallura nga KQZ-ja, prej të cilave 211 ishin apele, ndërsa tri të tjera ankesa. Për rezultatet përfundimtare, PZAP ka shqyrtuar edhe një kërkesë.

Bazuar në ndarjen sipas komunave ku kanë ndodhur shkeljet e supozuara, për sa i përket ankesave, prin Prishtina me 130 ankesa. Ndërsa, sa i përket apeleve, sa i përket apeleve, prin Prizreni me 44, i pasuar nga Drenasi me 41, Peja me 27 dhe Vushtrria me 26 sosh.

PZAP, kryesisht lidhur me regjistrimin e votuesve jashtë vendit, ka shqyrtuar mbi 360 apele dhe ankesa, shumica e së cilave janë paraqitur nga Gjermania (187 gjithsej).

Pothuajse gjysma e apeleve dhe ankesave të shqyrtuara nga PZAP janë parashtruar nga persona fizikë (371). Kurse, nga radhët e subjekteve politike, prin PDK me 124 lëndë të dorëzuara, prej të cilave 87 janë refuzuar, pasuar nga LVV me 117 lëndë të dorëzuara, prej

---

13 Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 qershor 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

---

të cilave 19 janë refuzuar, si dhe AAK me 81 lëndë të dorëzuara, prej të cilave janë refuzuar plot 75 prej tyre. Në anën tjetër, si kryes i shkeljeve të pretenduara, më së shumti ankesa dhe apele janë parashtruar kundër KQZ-së, me plot 411 sosh.

Ndër çështjet kryesore dhe më të rëndësishme të trajtuara, fillimisht, PZAP kishte trajtuar dy apele lidhur me vendimin e KQZ-së për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim të votuesve jashtë vendit, të cilat ishin parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dhe organizata jo-qeveritare Germin. Të dy këto ankesa ishin hedhur si të palejuara nga PZAP, duke lënë kështu në fuqi vendimin përkatës të KQZ-së, me këtë të fundit që pastaj nxori edhe udhëzim administrativ që detajoi çështjen në fjalë. Vendimet e PZAP ishin apeluar edhe në Gjykatën Supreme, mirëpo që edhe ajo nuk i kishte aprovuar apelet në fjalë.

Tutje, PZAP kishte trajtuar edhe 9 apele tjera lidhur me certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, përkatësisht moscertifikimin e shtatë subjekteve politike dhe listave të tyre të kandidatëve. Me anë të këtyre vendimeve në fjalë, PZAP kishte rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur për të njëjtën çështje edhe në vitin 2017, si dhe faktin që tashmë dispozita ligjore e nenit 29 të LZP, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, është shndërruar në normë dhe standard kushtetues. Ndërsa, Gjykata Supreme, pas apeleve të LVV-së, kishte konstatuar se PZAP ka bërë vlerësim të gabuar të afatit tre-vjeçar duke e llogaritur ditën e shpalljes së zgjedhjeve, 6 janar, si ditë përfundimtare për të vlerësuar afatin tre-vjeçar për përshtatshmërinë e kandidatëve. Gjykata Supreme e Kosovës kishte vlerësuar se afati duhet të llogaritet duke ju referuar datës së aktgjykimit penal të formës së prerë për secilin kandidat veç e veç e deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, që në këtë rast është data 14 shkurt 2021.

Lidhur me votimin jashtë vendit, PZAP kishte pranuar 144 si apele të bazuara, duke urdhëruar KQZ-në për përfshirjen e tyre në Listën e Votuesve jashtë vendit. Një pjesë tjetër e ankesave apo apeleve në PZAP kanë pasur të bëjnë me emërimet në KKZ-të e disa komunave, apo edhe KVV-të.

Sa i përket fushatës dhe heshtjes zgjedhore, që nga fillimi zyrtar i saj kishte vendosur në 139 raste gjithsej, lidhur me thyerjen e rregullave për fushatën zgjedhore,

prej të cilave 37 ishin vetëm për periudhën e fushatës, ndërsa 102 të tjera për heshtjen zgjedhore. Natyra e ankesave kryesisht është për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, duke përfshirë përdorimin e aseteve dhe objekteve publike gjatë fushatës zgjedhore, vendosjen e billbordeve në hapësirat e subjekteve tjera politike, përdorimin e personave të mitur gjatë fushatës, vendosjen e posterëve në rrugë publike, përdorimin e gjuhës së urrejtjes, mbajtjen e tubimeve publik pa paralajmërim, vendosjen e billbordeve në hapësirat e subjekteve tjera politike, vendosjen e billbordeve dhe panove në prona politike dhe përgjatë rrugëve, vendosjen e shiritave të kuq në rrugë, vendosjen e posterëve në shtylla elektrike, vendosjen e posterëve në objekte publike, si dhe vendosjen e grafitëve në objekte publike.

Demokracia në Veprim, përgjatë monitorimit të 10 ditëve të fushatës zgjedhore të subjekteve politike, ka dorëzuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) gjithsej shtatë ankesa, prej të cilave tri kundër AAK-së, nga një për Nismën Socialdemokrate, LDK-në, Iniciativën "Adrijana Hodžić" dhe PDK-në. Prej këtyre ankesave, katër janë aprovuar, ndërsa tri të tjera janë refuzuar.

Në kuadër të ankesave të aprovuara, dy janë për gjuhën e urrejtjes nga AAK dhe NISMA, subjekte të cilat janë dënuar me nga 20 mijë euro secila, si dhe dy ankesa të tjera kundër AAK-së për shkak të vendosjes së materialeve promovuese në hapësira të palejuara. Për këto dy të fundit, AAK është gjobitur me 2,700 euro gjithsej.

Ankesat e refuzuara kundër LDK-së, Iniciativës "Adrijana Hodžić" dhe PDK-së kanë pasur të bëjnë me moslajmërimin e takimeve në KKZ, mirëpo të njëjtat janë refuzuar si të pabazuara nga PZAP, meqenëse kjo e fundit ka konsideruar se Demokracia në Veprim nuk është palë që mund të ankimojë natyrë të tillë të shkeljes. Përkundër shkeljeve të shumta të kësaj natyre, të evidentuara nga vëzhguesit e DnV-së, si rezultat i refuzimit të ankesave paraprake të DnV-së nga PZAP, nuk janë depozituar ankesa tjera. Përndryshe, sipas dispozitave përkatëse, vetëm organet e rendit dhe KKZ-të kanë të drejtë ligjore që t'a njoftojnë PZAP-in për rastet e mosrespektimit të afateve kohore përkatëse nga subjektet politike për njoftim të ngjarjeve. Gjobat e parapara për këso shkelje, mund të arrijnë deri në vlera prej 20 mijë euro.



Gjatë ditës së zgjedhjeve, DnV ka dorëzuar në PZAP një ankesë kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për thyerje të heshtjes zgjedhore, përkatësisht për shkak të thirrjes së bartësit të kësaj liste për votimin e subjektit të tij, pasi që i njëjti kishte votuar. Për këtë shkelje, PDK është dënua nga PZAP me 25 mijë euro gjobë.

Pas përmbylljes së fushatës, PZAP kishte trajtuar edhe rreth 150 ankesa tjera lidhur me thyerjen e heshtjes zgjedhore dhe shkeljeve gjatë ditës së zgjedhjeve. Ankesat, sipas njoftimeve të PZAP-së, janë parashtruar nga individë, subjekte politike apo kandidatë të tyre, organizata, anëtarë të KKZ-ve dhe KVV-ve, dhe palë të tjera. Në kuadër të këtyre ankesave, PZAP i ka pranuar si të bazuara 117 ankesa, i ka refuzuar si të pabazuara 7,

i ka hedhur si të palejuara 11, i ka hedhur si të pasafatshme 2 sosh, dhe 1 tjetër është tërhequr. Për shkak të shkeljeve, të tilla si thyerja e heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit-për të votuar subjektin e caktuar politik, thirrja për të votuar disa kandidatë nëpërmjet portaleve të gazetave, shpërndarja apo postimi i disa fotografive me aktivitet elektoral në rrjete sociale, thirrje për të votuar nëpërmjet rrjeteve sociale, bërja e fushatës me veturë 100m afër qendrës së votimit, shpërndarja e SMS për votim tek qytetarët, vendosja e banerëve me foto të kandidatëve në afërsi të shkollës, vendosja e posterëve të kandidatëve në oborrin e Qendrës së Votimit, mbajtja e fushatës gjatë ditës së votimit, etj., PZAP ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike në vlerë prej 212,350 eurosh.

Subjekti politik	Shuma e gjobave të shqiptuara
<b>Partia Demokratike e Kosovës – PDK</b>	66,100.00 euro
<b>Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK</b>	52,750.00 euro
<b>Lëvizja Vetëvendosje! – LVV</b>	40,700.00 euro
<b>Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK</b>	24,600.00 euro
<b>Nisma Socialdemokrate – NISMA</b>	22,000.00 euro
<b>Lista Serbe – SL</b>	2,200.00 euro
<b>GJITHSEJ</b>	208,350.00 euro

TABELA 4 Gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike nga PZAP

Në fund, PZAP ka pranuar edhe 210 apele lidhur me vendimin e KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare. Prej tyre, janë aprovuar si të bazuara 16 prej tyre, ndërsa 9 të tjera janë aprovuar pjesërisht. Si rezultat i këtyre, PZAP kishte vendosur për rinumërimin e 134 vendotimeve, të gjitha votave me kusht dhe atyre me postë të AAK-së, si dhe kishte vendosur për anulimin e një pjese të konsiderueshme të votave të fituara nga subjektet politike nga radhët e komuniteteve,

sidomos boshnjak dhe atij rom, në zonat e banuara me shumicë serbe.

Në ditën e zgjedhjeve, Prokuroria e Shtetit ka caktuar 88 prokurorë kujdestarë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, bashkë me 40 persona staf mbështetës për prokurorët. Ndërsa, në anën tjetër, Këshilli Gjyqësor ka caktuar 30 gjyqtarë kujdestarë në nivel vendi për të pritur lëndët që mund të vijnë nga Prokuroria. PK ka sipas

---

obligimeve ligjore ka mbajtur rendin dhe ka siguruar secilën qendër të votimit.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, prokuroria, me ndihmën e policisë, ka ndërhyrë në disa raste, ku janë ndaluar persona të caktuar. Sidoqoftë, deri në ditën e hartimit të kësaj deklaratë, nuk është njoftuar zyrtarisht për numrin e rasteve të proceduara.

Sa i përket çështjeve të trajtuara nga PZAP, vlen të përmenden vendimet për anulimin e një pjese të votave të subjekteve Ujedinjena Zajednica - Adrijana Hodžić, si dhe Romani Inicijativa, të fituara në zonat e banuara me shumicë serbe. Në kuadër të këtyre dy apeleve, PZAP kishte gjetur se ekziston shpërputhje në mes të numrit të votuesve potencial nga komunitetet përkatëse dhe votave të fituara nga këto subjekte politike. Të gjeturat lidhur me numrin e banorëve të komuniteteve në fjalë, PZAP i kishte bazuar raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës të vitit 2011, Raportin e OSBE-së të vitit 2018, si dhe Listën Përfundimtare të Votuesve të verifikuar emër për emër, në vendvotimet në fjalë. Për më shumë, PZAP kishte konstatuar se orkestrimi i votave ndaj subjekteve të caktuara është standard jodemokratik, andaj si rrjedhojë, në mungesë të lidhjes objektive mes votuesve dhe subjektit të votuar, devijohet vullneti i votuesit, cenohet demokracia e brendshme zgjedhore dhe eliminohet gara në mes të subjekteve politike për vendet e garantuara – lidhur me të cilat e drejta e votës është e ndryshme me 100 vendet tjera.

Çështje tjetër e adresuar nga PZAP është dhe ajo e manipulimeve të supozuara në QNR nga stafi i atjeshëm, që sipas Panelit, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit të zgjedhjeve, do të cenohet edhe vet integriteti i procesit. PZAP kishte konstatuar se rritja në vota e një prej kandidatëve të listës së AAK-së, në raport me dy kandidatë tjera, ishte e paqartë, posaçërisht për shkak se ndryshime të pazakonta kishin ndodhur brenda dy netësh. Paneli po ashtu kishte marrë në konsideratë edhe video-incizimin përkitazi me këtë çështje, e cila kishte shërbyer si provë për dërgimin në rinumërim të të gjitha votave me kusht dhe atyre nga jashtë vendit për kandidatët e AAK-së.

Për zgjedhjet e 14 shkurtit, PZAP-ja ka trajtuar gjithsej 775 lëndë, prej të cilave 583 ishin apele, 189 ankesa, dy rishikime të vendimeve dhe një kërkesë për tërheqje. Sa i përket vendimeve të KQZ-së, PZAP ka trajtuar 578 apele dhe 21 ankesa. Nga gjithsej 775 lëndët e trajtuara, PZAP ka pranuar 309 prej tyre dhe ka pranuar pjesërisht 20 të tjera. 315 lëndë të tjera janë refuzuar, 64 janë hedhur si të palejuara, 51 janë hedhur si të pasafatshme, nëntë janë hedhur si të parregullta, pesë janë hedhur si të palejuara dhe të gjykuara, një është hedhur e palejuar si kërkesë për tërheqjen e apelit, si dhe një tjetër ishte kërkesë për tërheqje.

---

# REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të gjeturat dhe vlerësimet e dhëna në kuadër të këtij raporti, por edhe zhvillimeve të përgjithshme lidhur me procesin zgjedhor, Demokracia në Veprim ofron një sërë rekomandimesh të cilat synojnë përmirësimin e aspekteve teknike të zgjedhjeve, por edhe sistemin zgjedhor në përgjithësi.

Këto rekomandime, kanë për qëllim iniciimin e një **reforme zgjedhore përmbajtësore**, e cila duhet të përkthehet në ndryshime të kuadrit ligjor për zgjedhje, që adresojnë natyrën teknike të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve, por edhe elemente tjera politike të sistemit zgjedhor. Legjislacioni primar zgjedhor duhet të harmonizohet në funksion të përfshirjes së çështjeve të cilat aktualisht rregullohen vetëm përmes rregullave zgjedhore të miratuara nga KQZ-ja, të cilat përveçse në disa raste dalin përtej ligjit, nuk e kanë as fuqinë e njëjtë juridike.

DnV-ja vlerëson që reforma zgjedhore duhet të jetë një nga prioritetet kyçe të spektrit politik duke u bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës.

Rekomandimet në vijim, duhet të adresohen nga akterë të ndryshëm, duke filluar nga ligjvënësit, trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, subjektet politike dhe kandidatët e tyre, institucionet përkatëse të sigurisë dhe drejtësisë, shoqëria civile, si dhe institucionet tjera në fushëveprimin e të cilave bie përgjegjësia për ndonjë prej operacioneve zgjedhore.

## I. Reforma e sistemit zgjedhor

Demokracia në Veprim konsideron se është e domosdoshme që, përveç aspekteve teknike të përmirësimit të organizimit dhe administrimit zgjedhor, reforma zgjedhore të përfshijë edhe çështje përmbajtësore, që janë në thelb politike, e të cilat kërkojnë ndryshime kushtetuese e ligjore. Ndër elementet e sistemit zgjedhor, të cilat janë duke prodhuar probleme sidomos në përfaqësimin e drejtë qytetar, por dhe funksionalitetin institucional të Kosovës, që DnV vlerëson se duhet të jenë medoemos subjekt i reformës zgjedhore, janë:

1. **Votimi preferencial** deri në pesë kandidatë, duhet të reduktohet;
2. **Pragu zgjedhor**, përkatësisht aplikimi i tij për subjekte të ndryshme politike si partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur, duhet të rikategorizohet;
3. Mënyra së **zgjedhjes së Presidentit** të vendit, duhet të rishqyrtohet;
4. Të konsiderohet ndarja në **zona zgjedhore**;

## II. Administrimi i procesit zgjedhor dhe trupat menaxhuese të zgjedhjeve

Fillimisht, duke qenë se të gjitha zgjedhjet parlamentare që janë mbajtur pas shpalljes së pavarësisë kanë qenë të parakohshme, institucionet përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve në vazhdimësi kanë hasur në vështirësi për administrimin e operacioneve zgjedhore në mënyrë adekuate. Afatet e shkurtra kohore kanë ndikuar shpesh edhe në pa-

---

mundësimin e zhvillimit të mirëfilltë të aktiviteteve të parapara zgjedhore, apo edhe dështimin e tyre. Për këto arsye, DnV-ja vlerëson që bazuar edhe në praktikat e mira ndërkombëtare, afati kohor brenda së cilit duhet të mbahen zgjedhjet pas shpalljes së tyre nga ana e Presidentit, duhet të jetë minimalisht 45 ditë, por jo më shumë se 60 ditë.

1. KQZ-së duhet t'i kufizohet e drejta e marrjes së vendimeve dhe nxjerrjes së akteve lidhur me operacionet zgjedhore gjatë kohës kur të njëjtat janë në zhvillim e sipër, duke garantuar parimin e sigurisë juridike dhe mosndryshimit të rregullave të lojës gjatë saj. Në këtë drejtim, kufizimet duhet të vlejë për secilën fazë dhe operacion zgjedhor, të tilla si fushata zgjedhore, votimi jashtë vendit, certifikimi i kandidatëve, dita e zgjedhjeve, numërimi dhe të tjera.
2. Duke qenë se numërimi i votave, veçanërisht i atyre të kandidatëve, edhe në këto zgjedhje është treguar si hallkë e cenuar e procesit, duhet të rishikohet në tërësi. Si zgjidhje afatshkurtër, KQZ duhet të shqyrtojë mundësinë e angazhimit të komisionerëve të tjerë, vetëm për procesin e numërimit në secilin vendvotim. Kjo zgjidhje mundësohet edhe me nenin 74.2 të LZP. Ata mund të mbikëqyren nga stafi monitorues shtesë i angazhuar drejtpërdrejtë nga SKQZ.

Ndërsa, si zgjidhje të qëndrueshme, KQZ duhet të orientohet drejt dixhitalizimit të procesit të numërimit të votave, duke evituar gabimet njerëzore dhe manipulimet.

3. KQZ-ja duhet të zhvillojë trajnime dhe testime më rigorozë për anëtarët e KVV-ve, para se të njëjtit të caktohen në vendvotime, në mënyrë që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të kryhen më me profesionalizëm. Prioritet duhet të kenë procesi i numërimit, si dhe shkeljet më të shpeshta, të tilla si abuzimi me votimin me asistencë, cenimit të fshehtësisë së votimit dhe të ngjashme. Në këtë drejtim, edhe subjektet politike duhet të nominojnë komisionerë me integritet dhe përgatitje të duhur profesionale.
4. Të krijohen "lista të zeza" bazuar në performancën e stafit zgjedhor, përfshirë komis-

ionerët e KQZ-së dhe stafin në QNR, që është i dyshuar për manipulime apo të cilët kanë pasur performancë jo të kënaqshme. Të njëjtëve duhet t'u ndalohej pjesëmarrja në proces zgjedhor, deri në një vendim ndryshe të institucioneve kompetente.

5. Me synim të evitimit të rasteve të tentativave apo votimit të dyfishtë, duhet të ndërmerren hapat e nevojshëm për kalimin tek identifikimi biometrik ose elektronik të votuesve.
6. Fletat që shërbejnë për regjistrim të votave të kandidatëve (të njohura si FLLK) duhet të jenë pjesë e materialit të pranuar nga QNR përmes zarfeve, ku përfshihen edhe materialet tjera si LPV, Libri i Votimit, zarfet e votimit me kusht e të tjera. Kjo do të ndihmonte në krahasimin e rezultateve të dyshimta, pa pasur nevojë për vendimmarrje të KQZ-së në hapjen e kutive, siç ndodhë tani.
7. Pas përmbylljes së secilit proces zgjedhor, Librat e Votimeve, që janë të vendosura në secilin vendvotim, duhet të jenë objekt i auditimit nga KQZ-ja, në mënyrë që të evidentohen dhe trajtohen detajisht parregullsitë që janë hasur gjatë ditës së zgjedhjeve.
8. KQZ duhet të garantojë infrastrukturë të përshtatshme fizike, për qasje në secilin vendvotim dhe në format e qasshme të votimit për personat me aftësi të kufizuara.
9. Me qëllim të rritjes së transparencës gjatë numërimit të votave, duhet të bëhet rikonfigurimi i tavolinave të numërimit, në atë mënyrë që vëzhguesit të kenë qasje të qartë tek secili komisioner, por edhe gjatë bartjes së rezultateve nga Kryesuesi i vendvotimit, bazuar në modelin e përdorur në QNR.
10. Në kuadër të ndryshimeve ligjore, duhet medos të përfshihen edhe çështje të pa adresuara nga legjislacioni aktual, me fokus tek mekanizmi i anulimit të vendvotimeve në rast të mospërpjethjeve statistikore në formularët zyrtarë zgjedhor.

### III. Menaxhimi i zgjedhjeve në pandemi

1. Duke qenë se në vjeshtën e këtij viti do të mbahen zgjedhjet e rregullta lokale, si dhe faktit që pandemia pritet të shoqërojë edhe atë proces zgjedhor, është e domosdoshme që KQZ, të përgatis një plan konkret dhe të detajuar, që përcakton modalitetet e organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve në tërësi, në situatë pandemike. Mes tjerash, KQZ duhet të parashohë udhëzime dhe masa anti-COVID për të gjitha fazat e procesit, duke përfshirë informimin publik, trajnimet e stafit zgjedhor, administrimin e procesit të votimit, si dhe procesin e numërimit.

### IV. Votimi jashtë vendit

1. Votimit jashtë vendit vijon të mbetet operacion relativisht i parregulluar në aspektin ligjor, me shumë çështje që mbesin të papërcaktuara normativisht. Prandaj, duhet të bëhet një rishikim i plotë i legjislacionit zgjedhor për votimin jashtë vendit, duke përcaktuar qartazi procedurën e regjistrimit të votuesve, verifikimin e tyre, sfidimin e listës së votuesve, pranimin e fletëvotimeve dhe të tjera. Ndryshimet eventuale duhet të mënjanojnë çfarëdo hapësire për interpretim ambiguitiv të dispozitave përkatëse.
2. Duke synuar lehtësimin e mëtutjeshëm të këtij procesi për votuesit, duhet të vijohet me punën për zhvillimin dhe funksionalizimin e një aplikacioni online për regjistrimin e votuesve jashtë vendit, i cili përmban mekanizma të sigurisë për verifikimin e identitetit, dhe garantimin e fshtëhtësisë së votës. Sidoqoftë, lehtësimi i procedurave të regjistrimit dhe votimit nuk duhet të bëhet në kurriz të integritetit dhe besueshmërisë së këtij procesi.
3. Udhëzimi administrativ për verifikimin e aplikuesve nga jashtë vendit duhet të rishikohet, duke synuar nxjerrjen e mësimave nga problemet që kanë shoqëruar këtë proces, me qëllim të evitimit të tyre për proceset e ardhshme zgjedhore.
4. Qytetarëve dhe palëve tjera duhet t'iu ofrohet më shumë hapësire kohore për sfidimin dhe

kontestimin e Listës së Votuesve Jashtë Vendi, posaçërisht qytetarëve të cilëve u është refuzuar aplikimi për t'u regjistruar si votues jashtë vendit. Në këtë mënyrë, do të evitohen edhe manipulimet e ndryshme që mund të bëhen në emër të votuesve të tjerë.

5. Ndryshimet ligjore duhet të përfshijnë çështjen se kush mund të aplikojë për të qenë votues jashtë vendit. Dispozitat duhet t'a kufizojnë këtë të drejtë vetëm për qytetarët e Kosovës, të cilët kanë dokumente të vlefshme, siç vlen edhe për zgjedhjet brenda Kosovës. Personave të cilët kanë hequr dorë apo nuk kanë fare shtetësi të Kosovës duhet t'u mohohet e drejta për të qenë votues për zgjedhjet në Kosovë.

### V. Dizajni i fletëvotimit

1. Përkundër faktit që përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme nuk ka shënuar ndonjë rritje shqetësuese krahasuar me zgjedhjet paraprake, dhe është nën mesataren e vendeve evropiane, duhet të vijohet me përpjekje për t'a ulur edhe më tej këtë përqindje, duke evituar humbjen e votave.
2. Duke qenë se dizajni i fletëvotimit ka rol të madh në evitimin e mundësisë së gabimeve nga votuesit, DnV ka kohë që ka propozuar një dizajn të ri të testuar me qytetarë, andaj i njëjti duhet të merret parasysh dhe të përdoret në ciklet e ardhshme zgjedhore nga KQZ-ja.

### VI. Informimi i votuesve

1. Fushatat për informimin dhe edukimin e votuesve duhet të jenë të vazhdueshme dhe jo vetëm gjatë periudhave të zgjedhjeve. Targetet primare të këtyre kampanjave informuese duhet të përcaktohen mbi bazën e analizave të cilat evidentojnë zonat dhe grupet demografike që kanë më shumë nevojë për informim dhe edukim.
2. Cilësia e produkteve të fushatës për informim dhe edukim të votuesve nga KQZ-ja, duhet të vijojë të përmirësohet, si në aspektin vizual,

ashtu edhe në atë përmbajtësor. Produktet duhet t'i përshtaten mjeteve të komunikimit ku ato plasohen.

## VII. Fushata zgjedhore

1. Subjektet politike në pushtet duhet t'i përmbahen dispozitave ligjore lidhur me mospërdorimin e resurseve publike në fushatë, veprime këto të cilat janë rreptësisht të ndaluara. Përfshirja e fëmijëve dhe shërbyesve publik e civilë në aktivitete të fushatës për qëllime elektorale duhet të ndërpritet si praktikë e subjekteve politike, dhe të sanksionohet. Në këtë aspekt, rekomandohet që korniza ligjore të rishikohet dhe të sqarohet, në funksion të parandalimit të shfrytëzimit të resurseve publike.
2. Zhvillimi i aktiviteteve elektorale nga subjektet politike para fillimit zyrtar të fushatës, duhet të rregullohet me ligj. Rrjedhimisht, edhe shpenzimet e bëra nga subjektet politike dhe kandidatët të tyre gjatë kësaj periudhe duhet të jenë pjesë integrale e kufizimit të shpenzimeve, i cili caktohet nga KQZ-ja.
3. Personave me aftësi të kufizuara duhet t'iu ofrohet qasje adekuate fizike në secilin aktivitetet të organizuar gjatë periudhës së fushatës, si dhe përmbajtja e programeve të ofrohet në formate të përshtatshme të caktuara për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

## VIII. Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës

1. Financimi i subjekteve politike, sidomos gjatë periudhës së fushatës, duhet të avancohet. Subjektet politike duhet të hapin llogari të veçanta bankare për financimin dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës, të cilat duhet të jenë transparente dhe të qasshme për publikun, në faqen elektronike të KQZ-së, ndonjë portal tjetër, ose në faqet elektronike të vetë subjektit politik apo kandidatëve.

2. Subjektet politike dhe kandidatët e tyre duhet t'i përmbahen në mënyrë strikte kufizimeve të KQZ-së për shpenzimet gjatë fushatës.
3. Reforma zgjedhore duhet patjetër të rregullojë çështjen e deklarimit financiar për kandidatët e subjekteve politike, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet personale për periudhën gjatë fushatës.
4. Subjektet politike duhet të bëjnë transparente mënyrën e shpërndarjes së fondeve të tyre për kandidatet gra, me qëllim që të ketë përkrahje të barabartë për të gjithë kandidatët.
5. Auditimi i financave dhe shpenzimeve të fushatës së subjekteve politike duhet të përmbillet brenda afateve të parapara ligjore. Ndërsa, reforma duhet të parashohë edhe ndryshimin e modelit aktual për auditim, duke e kthyer këtë kompetencë nga Kuvendi tek ZRPPC – mandati i së cilës do të duhej të fuqizohej ndjeshëm.

## IX. Lista e votuesve

1. Nevojitet përcaktim i qartë ligjor lidhur me dokumentet e vlefshme që mund të përdoren për votim. Votimi me dokumente me afat të skaduar duhet të sanksionohet ligjërisht.
2. Përkundër përmirësimeve të ndjeshme me heqjen e mbi 130 mijë personave nga Lista e Votuesve, pasaktësia e listës së votuesve mbetet një shqetësim mbi të cilin duhet të zhvillohen përpjekje të vazhdueshme. Institucionet mund të shohin edhe për mundësinë e regjistrimit aktiv të votuesve. Sistemi i unifikuar dhe i integruar i adresave duhet të fillojë të zbatohet sa më shpejtë.
3. Institucionet përkatëse duhet të shohin mundësinë për përdorimin e metodave tjera inovative për informimin e qytetarëve për Qendrën e Votimit dhe vendvotimin ku ata mund të ushtrojnë të drejtën e votës, duke përdorur modelin e dërgimit të SMS-ëve, dërgimit të njoftimeve përmes postës së rregullt apo adresave elektronike.

---

## X. Përfaqësimi gjinor

1. Listat zgjedhore të subjekteve politike duhet të reflektojnë përfaqësim të barabartë gjinor, duke përdorur modelin 'zebra' - që garanton se çdo i dyti kandidat është i gjinisë tjetër.
2. Përkundër rritjes së numrit të grave deputete që kanë fituar mandat pa kuotë, duhet të ndërmerren iniciativa për kuotë të përfaqësimit të barabartë edhe në Kuvend.
3. Subjektet politike duhet të nominojnë më shumë gra në përbërje të Komisioneve Komunale Zgjedhore, Këshillave të Vendotimeve dhe ekipeve mobile. Në të ardhmen duhet të shtohen përpjekjet për garantimin e përfaqësimit të barabartë gjinor 50-50 në trupat menaxhuese të zgjedhjeve.

## XI. Drejtësia zgjedhore

1. Organet e ndjekjes duhet të trajtojnë me prioritet rastet kur komisionerët kanë tentuar apo kanë deformuar vullnetin zgjedhor të qytetarëve. Për më tepër, organet duhet të aplikojnë sanksionet maksimale për rastet në fjalë.
2. Institucionet e sigurisë dhe ato të drejtësisë duhet të veprojnë proaktivisht lidhur me situatat dhe denoncimet publike për cenimin e përcaktimit të lirë të votuesve, intimidimin e kandidatëve si dhe qytetarëve të komunave me shumicë serbe, por jo vetëm.

# Shtojca 1:

Rezultatet e certifikuara te zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike


Subjekti politik	Numri i votave	Përqindja	Numri i ulëseve
127. LËVIZJA VETËVENDOSJE!	438,335	50.280%	58
134. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS – PDK	148,285	17.009%	19
132. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS – LDK	110,985	12.731%	15
135. ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS - AAK	62,111	7.124%	8
119. SRPSKA LISTA	44,407	5.094%	10
121. NISMA SOCIALDEMOKRATE - NISMA	21,997	2.523%	0
112. KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI – KDTP	6,496	0.745%	2
113. KOALICIJA VAKAT	5,366	0.616%	1
111. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	3,305	0.379%	1
124. ROMANI INICIYATIVA - RI	3,172	0.364%	1
131. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS	2,885	0.331%	1
125. SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU	2,549	0.292%	1
136. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE	2,430	0.279%	0
129. UJEDINJENA ZAJEDNICA - ADRIJANA HODŽIĆ - UZ-AH	2,217	0.254%	0
137. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP	2,161	0.248%	1



<b>Subjekti politik</b>	<b>Numri i votave</b>	<b>Përqindja</b>	<b>Numri i ulëseve</b>
130. PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI	2,138	0.245%	1
128. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK	1,960	0.225%	0
115. GI ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK - GI SPO	1,508	0.173%	0
133. NAŠA INICIJATIVA - NAŠA	1,375	0.158%	0
116. LËVIZJA PËR BASHKËVEPRIM - LpB	1,261	0.145%	0
114. YENİLİKÇİ TÜRK HAREKET PARTİSİ - YTHP	1,243	0.143%	0
123. LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS - LPRK	1,208	0.139%	1
138. FJALA	1,087	0.125%	0
117. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK	1,074	0.123%	0
122. KOALICIJA ZAJENO	1,010	0.116%	0
126. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP	600	0.069%	0
118. SRPSKI DEMOKRATSKI SAVEZ - SDS	476	0.055%	0
120. PARTIA BALLISTE - PB	155	0.018%	0







Federal Department of Foreign Affairs FDFA